USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

# INDEKSI I KONKURRUESHMËRISË SË KOMUNAVE

2018



# PËRMBAJTJA


SHKURTESAT.............................................. 4

1. PËRMBLEDHJE E SFONDIT EKONOMIK DHE MJEDISIT AFARIST ........................... 6

2. ÇFARË ËSHTË IKK? ............................. 7

3. INDEKSI IKK DHE REZULTATET E NËN-INDEKSEVE................................... 9

4. REZULTATET E NËN-INDEKSEVE......... 13

4.1. NËN-INDEKSI 1: BARRIERAT E HYRJES NË BIZNES.......................................................13

4.2. NËN-INDEKSI 2: TRANSPARENCA.................4

4.3. NËN-INDEKSI 3: PJESËMARRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA.......................................13

4.4. NËN-INDEKSI 4: KOSTOT KOHORE ...............21

4.5. NËN-INDEKSI 5: TAKSAT DHE TARIFAT.........29

4.6. NËN-INDEKSI 6: ADMINISTRATA LOKALE.....37

4.7. NËN-INDEKSI 7: FUQIA PUNËTORE DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR BIZNESE .........43

4.8. NËN-INDEKSI 8: INFRASTRUKTURA LOKALE........................................................... 50

5. IKK I PESHUAR NË BAZË TË POLITIKAVE PUBLIKE.............................. 56

6. GJETJET NGA DISKUTIMET NË GRUPE TË FOKUSUARA...................................... 60

7. METODOLOGJIA E IKK-SË ................... 64

7.1. GRUMBULLIMI ...........................................65

DIZAJNI I ANKETËS...........................................65

MOSTRA ..........................................................65

MBLEDHJA E TË DHËNAVE ................................67

7.2. NDËRTIMI...................................................68

7.3. KALIBRIMI ...................................................68

7.4. DISKUTIMET NË GRUPET E FOKUSUARA - METODOLOGJIA...........................71

8. PËRFUNDIMET .................................. 73

9. SHTOJCAT ......................................... 74








# SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **ARBK** | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës |
| **IKK** | Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave |
| **IQE** | Indeksi i Qeverisjes Ekonomike |
| **NVM** | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |
| **OJQ** | Non-Governmental Organization |
| **USAID** | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Qëllimi i studimit të Indeksit të Konkurrueshmërisë së Komunave të Kosovës (IKK) është matja e konkurrueshmërisë së qeverisjes komunale në krijimin e një mjedisi të favorshëm afarist në nivel lokal. Kjo është hera e pestë që USAID-i në Kosovë zbaton studimin e IKK-së me qëllim të orientimit të reformave të politikave publike, bazuar në dëshmi.[1]

IKK ka filluar si domosdoshmëri për të identifikuar pikat e forta dhe pengesat me të cilat përballet sektori privat gjatë ndërveprimit me komunat e tyre, si dhe për të identifikuar fushat për krijimin e parakushteve të një sektori të qëndrueshëm privat. Si i tillë, kontributi më i rëndësishëm i IKK-së është në fokusin e tij lokal dhe në identifikimin e fushave të rëndësishme të politikave publike. Shumica e studimeve dhe politikave ekzistuese që lidhen me mjedisin afarist janë të përqendruara në nivel kombëtar, dhe IKK ofron informacion plotësues për reforma më koherente të politikave publike në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes.

IKK është një indeks që hartohet në vende të ndryshme, qoftë individualisht në nivel vendi ose si pjesë e një rajoni më të gjerë brenda një vendi të caktuar. Metodologjia e përdorur për ndërtimin e indeksit bazohet në metodologjinë e standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike (IQE; ang. EGI) nga Fondacioni Aziatik. IKK është një indeks i përbërë nga 8 nën-indekseve të standardizuara që matin dimensionet kryesore të ndikimit të qeverisjes lokale në mjedisin afarist. Studimi bazohet në të dhënat primare të mbledhura përmes anketimit të 3350 ndërmarrjeve private në të gjitha 38 komunat e Kosovës duke përdorur një mostër të shtresuar dhe të përzgjedhur në mënyrë rastësore.

Një tipar i rëndësishëm i IKK-së së këtij viti është përfshirja e diskutimeve nga grupet e fokusuara. Shtatë grupe të fokusuara janë organizuar në shtatë rajone të Kosovës me qëllim të nxjerrjes në pah të përvojave dhe sugjerimeve nga zyrtarët komunalë, OJQ-të vendore dhe bizneset, në mënyrë që të plotësohen të dhënat e anketës edhe me të dhëna cilësore.

IKK si indeks i përbërë tregon se komunat mund të krijojnë një mjedis të favorshëm afarist, pavarësisht madhësisë së tyre. Komunat në vijim janë renditur si 5 komunat e para: Lipjani, Rahoveci, Vitia, Juniku dhe Hani i Elezit, ndërsa pjesa tjetër e komunave me performancë më të mirë janë të një madhësie të përzier dhe përfshijnë: Gjakovën, Podujevën, Obiliqin, Prishtinën dhe Suharekën.

Nga një perspektivë e përgjithshme, rezultatet tregojnë se **indeksi i kostove kohore** (shpenzimeve që ndërlidhen me kohën e shpenzuar) nga bizneset rangohet si nën-indeksi me rezultatin më të lartë, duke treguar se bizneset në të gjithë vendin nuk janë të ngarkuar me burokraci të tepërt që konsumojnë kohën e tyre. Nën-indeksi i **pengesave për hyrje në biznes,** është nën-indeksi vijues me vlerën me të lartë, i cili konfirmon një ambient të favorshëm për fillimin e një biznesi nga perspektiva e pengesave administrative që lidhen me hyrjen në biznes. Nga ana tjetër, nën-indeksi i **transparencës** ka marrë pikët më të ulëta, duke treguar një qasje të kufizuar në të dhënat dhe informacionet që ofrohen nga komunat. Raporti është i organizuar në tetë seksione kryesore. **Seksioni i parë** diskuton mjedisin e përgjithshëm afarist bazuar në literaturën ekzistuese. **Seksioni i dytë** është një pasqyrë e IKK-së. **Seksioni i tretë** paraqet indekset në nivel agregat. **Seksioni i katërt** është i ndarë në 8 pjesë që diskutojnë nën-indekset e IKK-së. **Seksioni i pestë** jep një pasqyrë të peshave të politikave të IKK-së. Diskutimet nga grupet e fokusit janë paraqitur **në seksionin e gjashtë.** **Seksioni i shtatë** shpjegon metodologjinë e përdorur në ndërtimin e indekseve. Në fund, **pjesa e tetë** përmbledh raportin përmes një konkluzioni.

1 IKK 2018 është zbatuar pas një boshllëku 4-vjeçar, përderisa IKK e fundit në Kosovë është zbatuar në vitin 2014.

# 1 PËRMBLEDHJE E SFONDIT EKONOMIK DHE MJEDISIT AFARIST

Fokusi i këtij studimi është të analizojë rolin dhe ndikimin e qeverisjes lokale në krijimin e një mjedisi të shëndoshë për bizneset dhe sektorin privat në përgjithësi. Ecuria e bizneseve luan një rol të madh në krijimin e parakushteve për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Sektori privat në Kosovë, i cili është i dominuar nga mikro-ndërmarrjet, ka qenë i dobët dhe vetëm kohët e fundit është bërë nxitësi kryesor i rritjes ekonomike. Përkundër trendit pozitiv të rritjes ekonomike gjatë dekadës së fundit, ritmet e rritjes ekonomike të Kosovës nuk ishin transformuese, pra nuk ishin në gjendje të përballonin sfidat si papunësia dhe varfëria e lartë. Gjendja ekonomike në Kosovë karakterizohet ende nga pabarazitë makroekonomike, të cilat reflektohen me një nivel të lartë të papunësisë (rreth 30 për qind)[2] nivelet e larta të informalitetit (duke qëndruar rreth 31%)[3] dhe deficiti i lartë tregtar (duke qëndruar rreth 35% në raport me PBB)[4]. Progresi i ngadaltë në rritjen e produktivitetit dhe mbështetjen e prodhimit dhe eksporteve, reflektojnë faktin se Kosova nuk ka një kuadër të integruar të politikave ekonomike. Kjo, nga ana tjetër, reflektohet në konkurrueshmëri të ulët dhe norma të moderuara të rritjes.

Në renditjen botërore të të bërit biznes nga Banka Botërore 2018, Kosova ka shënuar një përmirësim të jashtëzakonshëm, duke zënë vendin e 40-të krahasuar me vendin e 86-të katër vjet më parë. Kjo e ka vënë ekonominë e Kosovës në mesin e dhjetë reformuesve më të lartë në botë.[5] Në veçanti, krijimi i zyrave me një ndalesë (one-stop shops) në 26 komuna ka përmirësuar disa aspekte të barrierave hyrëse dhe një gjë e tillë është evidentuar edhe nga IKK-ja. Përderisa janë bërë përmirësime të rëndësishme në të gjithë treguesit e të bërit biznes, mjedisi afarist në Kosovë ende ballafaqohet me shumë pengesa. Indeksi i Barometrit të Ballkanit, sugjeron që Kosova ka shumë punë për të bërë për të arritur një mjedis të qëndrueshëm institucional për mbështetjen e biznesit.[6]

Në nivel kombëtar, rreziqet kryesore lidhen kryesisht me pasigurinë politike që mund të ndikojë në investime dhe rritje. Bizneset ballafaqohen me shumë pengesa infrastrukturore (si cilësia e rrugëve dhe hekurudhat), barriera institucionale (si korrupsioni, evazioni fiskal dhe informaliteti, kostoja e financimit, cilësia e sistemit gjyqësor, cilësia e administratës tatimore, ndër të tjera) barriera të brendshme (të tilla si cilësia dhe disponueshmëria e fuqisë punëtore). Të gjitha këto të kombinuara tregojnë se mjedisi afarist nuk nxit zhvillimin e shpejtë të sektorit privat. Prandaj, veprimet që adresojnë këto pengesa, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, janë me rëndësi të madhe, veçanërisht në fazën aktuale të zhvillimit të Kosovës.

Në këtë mënyrë, ky raport kërkon të kuptojë se cilat përmirësime të politikave publike duhet të bëhen për të mundësuar sektorin privat të zhbllokojë potencialin e tij dhe të rrisë konkurrueshmërinë, si brenda në nivel komunal, ashtu edhe dhe jashtë në nivel rajonal dhe global.

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017) Anketa e Fuqisë Punëtore.

3 Riinvest (2017). Mjedisi banesor në Kosovë. Nga perspektiva e NVM-ve.

4 Riinvest (2017) – Forum 2015, "Përgjigje ndaj sfidave te rritjes ekonomike".

5 http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2017/10/31/doing-business-2018-kosovo-among-top-ten-reformers-in-the-world.

6 Regional Cooperation Council (2017). Business opinion survey - Balkan Barometer.

# 2 ÇFARË ËSHTË IKK?

Indeksi i Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK) është një indeks që hartohet në vende të ndryshme, qoftë individualisht në nivel vendi ose si pjesë e një rajoni më të gjerë brenda një vendi të caktuar. Qëllimi i këtij indeksi është të zhvillojë një tregues në nivel komunal i cili do të tregojë performancën e qeverisjes lokale duke u përpjekur të kapë dimensionet e ndryshme të konkurrueshmërisë në nivel lokal. Për dallim nga metodologjitë e përdorura për indekset e ndryshme të biznesit në nivel kombëtar, IKK përdor një metodologji të zhvilluar posaçërisht për t'u përdorur në nivel komunal. Në këtë hulumtim janë nxjerrë tetë nën-indekse dhe gjithashtu është krijuar një indeks i veçantë për secilën komunë.

Metodologjia e përdorur për nxjerrjen e nën-indekseve është diskutuar në seksionin e veçantë të metodologjisë. IKK prezanton një mundësi të re për të kuptuar pengesat që bizneset kanë identifikuar në komunat e tyre përkatëse. Këto rezultate japin një pasqyrë të qartë të prioriteteve kryesore ku komunat duhet të përqendrohen, duke rritur konkurrueshmërinë dhe në të njëjtën kohë duke krijuar kushte më të mira për të bërë biznes.

Indekse të konkurrueshmërisë për njësitë administrative komunale dhe provinciale që rendisin qytete, rajone apo provinca në tema të ndryshme, janë hartuar nga organizata të ndryshme në nivel të ndryshëm rajonal, konkretisht Raporti i Konkurrueshmërisë Globale i hartuar nga Forumi Ekonomik Botëror dhe Indeksi Rajonal i Konkurrencës i BE-së i përgatitur nga Komisioni Evropian, duke matur nivelet e ndryshme të konkurrueshmërisë në lidhje me kompetencat e qeverive qendrore, të tilla si shëndetësia, arsimi, teknologjia dhe inovacioni. Metodologjia e përdorur për Kosovën bazohet në Indeksin e Qeverisjes Ekonomike (IQE) të zhvilluar nga Fondacioni Aziatik. Metodologjia e IQE-së është përdorur në masë të madhe në vendet e Azisë Juglindore dhe ka marrë një vëmendje të gjerë nga politikëbërësit në Vietnam, Bangladesh, Indonezi, Kamboxhia, Filipine dhe Sri Lankë.

Këto indekse janë zhvilluar në bazë të specifikave të çdo vendi, ku fokusi i hulumtimit ka qenë në nivelin të provincave ose rajoneve të secilit vend. Kështu, ndërtimi i indekseve reflekton edhe dallimet midis këtyre vendeve. Sidoqoftë, qëllimi i përbashkët përfundimtar për çdo indeks IQE të shqyrtuar është të informojë politikëbërësit për mundësitë e tyre për të përmirësuar produktivitetin dhe performancën e sektorit privat duke reduktuar pengesat, duke eliminuar procedurat e tepërta administrative, duke krijuar një ambient të drejtë ligjor dhe duke ofruar kushte të nevojshme infrastrukturore. Gurthemeli i metodologjisë së IQE-së, që përdoret në të gjitha ekonomitë e analizuara, është mbledhja e të dhënave primare përmes anketimeve me pronarët e bizneseve dhe ndërmarrësit.

Duke pasur parasysh nevojën për përmirësim të konkurrueshmërisë së biznesit dhe qeverisjes vendore, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ka filluar me një metodologji të IQE-së të përshtatur për Kosovën të quajtur IKK. IKK është realizuar në Kosovë çdo vit që nga viti 2010, me përjashtim të vitit 2014 dhe 2015. Hulumtimi në vitet e fundit u prit mirë nga politikëbërësit në Kosovë. Ajo që ndryshon nga raporti i kaluar i IKK-së është se këtë vit metodologjia përfshin diskutime me grupe të fokusuara duke plotësuar të gjeturat me të dhëna cilësore.

Rasti i Kosovës ndryshon për faktin se nën-indekset bazohen në nxjerrjen e të dhënave se sa komunat kanë fuqi për të krijuar kushte për zhvillimin e konkurrueshmërisë ekonomike për bizneset. Rrjedhimisht, qëllimi i këtyre raporteve është për të vlerësuar qeverisjen ekonomike në nivel komunal dhe për të filluar diskutimet mbi strategjitë lokale që rrisin nivelin e ndërveprimit ndërmjet nevojave të sektorit privat në ofrimin e produkteve që rrisin produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e secilës komunë. Analiza e mëtejshme e metodologjisë së përdorur me të gjitha specifikat e Kosovës është shpjeguar në kapitullin e metodologjisë.

# 3 INDEKSI IKK DHE REZULTATET E NËN-INDEKSEVE

IKK është hartuar për të vlerësuar lehtësinë e të bërit biznes dhe rolin e qeverisjes ekonomike në sigurimin e një mjedisi të favorshëm afarist në nivelin komunal. Si një matje sasiore, IKK gjithashtu siguron një pikë referimi për komunat për të ndjekur përparimin e tyre në sigurimin e një mjedisi të mirë afarist dhe një platformë për shkëmbimin e praktikave të suksesshme me njëra-tjetrën.

IKK është një konstrukt i 8 nën-indekseve të standardizuar që matin dimensionet kyçe të ndikimit të qeverisjes lokale në mjedisin afarist.



1 **Barrierat e hyrjes në biznes -** kostot që lidhen me hyrjen në treg dhe drejtësinë e konkurrencës në tregun lokal.



2 **Transparenca** - qasja e përgjithshme e biznesit në informata dhe dokumente të ndryshme publike në nivel lokal.



3 **Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria** - shkalla në të cilën komunat përfshijnë bizneset në vendimmarrje dhe besimin e bizneseve në parashikimin e mjedisit të politikave publike.



4 **Kostot kohore -** koha që ndërmarrjet kalojnë duke siguruar pajtueshmëri me rregulloret dhe kohën që ndërmarrjet kalojnë në inspektimet e biznesit nga agjencitë komunale.



5 **Taksat dhe tarifat** - se si bizneset perceptojnë barrën e përgjithshme të taksave dhe tarifave të ngarkuara.



6 **Administrata komunale -** aftësitë e zyrtarëve komunalë dhe qëndrimet ndaj bizneseve dhe drejtësia në procesin e tenderimit.



7 **Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese -** kënaqësinë e bizneseve me nivelin e arsimit dhe aftësive profesionale të ofruara në treg.



8 **Infrastruktura komunale -** cilësinë e rrugëve dhe mirëmbajtjes së rrugëve, shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Secili nga nën-indekset ka një maksimum prej 10 pikësh, dhe IKK është një mesatare e thjeshtë e 8 nën-indekseve. Në seksionin 5, indeksi është peshuar në bazë të rëndësisë së politikave që mbulojnë nën-indekset, megjithatë në diskutimin e mëposhtëm indeksi është i peshuar në mënyrë të barabartë.

Tabela 3.1 paraqet rezultatet e nën-indeksit në nivel kombëtar. Nga një perspektivë e përgjithshme, rezultatet tregojnë se **indeksi i kostove kohore** nga bizneset rangohet si nën-indeksi me rezultatin më të lartë (9.2), duke treguar se bizneset në të gjithë vendin nuk janë të ngarkuar me burokraci të tepërt që konsumojnë kohën e tyre.

Nën-indeksi i **pengesave për hyrje në biznes,** është nën-indeksi vijues me vlerën me të lartë (7.9), i cili konfirmon një ambient të favorshëm për fillimin e një biznesi nga perspektiva e pengesave administrative që lidhen me hyrjen në biznes.

Nga ana tjetër, nën-indeksi i **transparencës** ka marrë pikët më të ulëta (4.1), duke treguar një qasje të kufizuar në të dhënat dhe informacionet që ofrohen nga komunat.

Figura 3.1 tregon indeksin e përbërë të IKK-së për secilën komunë. Dallimet në vlerat e indeksit komunal nuk është i madh, pasi indeksi paraqet një mesatare të thjeshtë të vlerave të nën-indekseve dhe kështu nuk përfill ndryshimin brenda indekseve (gjë që është paraqitur në seksionet vijuese). Dhjetë komunat me performancë më të mirë janë renditur në Tabelën 3.2, ku prijnë Lipjani dhe Rahoveci. Komunat që janë në kuartalin e sipërm të ranglistës paraqesin gjithashtu 10 komunat që kanë treguar rezultatin më të mirë.

TABELA 3.1 Nën-indekset e IKK-së, në nivel kombëtarë

| | REZULTATI NË NIVEL KOMBËTARË |
|---|---|
| Barrierat e hyrjes në biznes | 7.9 |
| Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria | 4.1 |
| Transparenca | 5.3 |
| Kostot kohore | 9.2 |
| Taksat dhe tarifat | 6.2 |
| Administrata komunale | 4.6 |
| Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese | 4.7 |
| Infrastruktura komunale | 6.5 |

# INDEKSI I KONKURRUESHMËRISË SË KOMUNAVE 2018

## IKK - KOMUNAT ME PERFORMANCË MË TË MIRË

| | KOMUNA | IKK |
|---|---|---|
| 1 | Lipjan | 7.0 |
| 2 | Rahovec | 6.8 |
| 3 | Viti | 6.6 |
| 4 | Junik | 6.6 |
| 5 | Hani i Elezit | 6.5 |
| 6 | Gjakovë | 6.5 |
| 7 | Podujevë | 6.3 |
| 8 | Obiliq | 6.3 |
| 9 | Prishtinë | 6.3 |
| 10 | Suharekë | 6.3 |




0.0-1.0 | 1.0-2.0 | 2.0-3.0 | 3.0-4.0 | 4.0-5.0 | 5.0-6.0 | 6.0-7.0 | 7.0-8.0 | 8.0-9.0 | 9.0-10.0




| KOMUNA | IKK |
|---|---|
| Lipjan | 7.0 |
| Rahovec | 6.8 |
| Viti | 6.6 |
| Junik | 6.6 |
| Hani i Elezit | 6.5 |
| Gjakovë | 6.5 |
| Podujevë | 6.5 |
| Obiliq | 6.3 |
| Prishtinë | 6.3 |
| Suharekë | 6.3 |
| Partesh | 6.3 |
| Istog | 6.3 |
| Kllokot | 6.2 |
| Pejë | 6.2 |
| Kaçanik | 6.2 |
| Novobërdë | 6.2 |
| Zubin Potok | 6.1 |
| Mamushë | 6.1 |
| Shtime | 6.1 |
| Prizren | 6.1 |
| Skenderaj | 6.0 |
| Malishevë | 6.0 |
| Mitrovicë | 6.0 |
| Gllogoc | 6.0 |
| Vushtrri | 5.9 |
| Ferizaj | 5.9 |
| Graçanicë | 5.9 |
| Ranillug | 5.9 |
| Kamenicë | 5.9 |
| Dragash | 5.8 |
| Deçan | 5.8 |
| Gjilan | 5.8 |
| Fushë Kosovo | 5.7 |
| Shtërpcë | 5.7 |
| Mitrovica e Veriut | 5.4 |
| Zveçan | 5.4 |
| Leposaviq | 5.3 |
| Klinë | 5.0 |

Burimi: Anketa 2018, llogaritjet e autorëve

# 4 REZULTATET E NËN-INDEKSEVE

# NËN-INDEKSI 1: BARRIERAT E HYRJES NË BIZNES

Barrierat e hyrjes në biznes janë një tregues i rëndësishëm i mjedisit afarist që përshkruan drejtësinë e konkurrencës në tregun vendor, si dhe kostot që lidhen me hyrjen në treg. Në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore, Kosova është ngjitur në pozitën e 40-të në nivel global, duke treguar një përmirësim thelbësor në kushtet për fillimin e një biznesi dhe funksionimin e një firme vendore. Qeveria qendrore ka punuar me Bankën Botërore duke ndërmarrë masa të reja që ulin pengesat për hyrje në biznes. Një nga politikat më të mëdha të zbatuara ishte delegimi i shërbimeve të regjistrimit të bizneseve nga regjistrimi kombëtar, pra nga Agjencia Kosovare e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) në zyrat e ARBK-së në administratën komunale. Modeli i ri i ka ndihmuar bizneseve të përfundojnë procedurat e regjistrimit në më pak ditë dhe me kosto më të ulëta. Masat e tjera janë përqendruar në uljen e numrit të dokumenteve, lejeve dhe taksave të kërkuara për regjistrim.

Nën-indeksi i IKK-së për barrierat në hyrje vlerëson pengesat që kanë bizneset duke u fokusuar veçanërisht në barrierat që shfaqen në nivel lokal. Dallimet në barrierat e hyrjes midis komunave vlerësohen nga dy perspektiva kryesore: koha dhe dokumentet e nevojshme për regjistrimin e një biznesi dhe barrierat e hyrjes.

Figura 4.1.1 tregon rezultatet e nën-indeksit të barrierave të hyrjes për të gjitha komunat e Kosovës. Gjatë interpretimit të rezultateve, duhet të kihet parasysh se bizneset në komuna më të vogla kanë qasje në shërbime më të bollshme dhe më fleksibile nga komuna krahasuar me komunat me dendësi më të madhe të bizneseve.

Nën-indeksi i IKK-së për barrierat në hyrje tregon se komuna me rangimin më të mirë është Kllokoti, me një indeks pothuajse të përsosur prej 9.9 nga një maksimum prej 10. Komuna me performancë më të lartë janë: Mamusha (9.5), Novobërda (9.0), Peja (9.0), Podujeva (8.8), Graçanica (8.5) dhe Prishtina (8.5).

Në anën tjetër, komunat ku bizneset kanë pengesa më të mëdha gjatë hyrjes janë: Malisheva, Deçani, Klina, Gllogoci, Ferizaji.




Tabela 4.1.1

# KOMUNAT ME PERFORMANCË MË TË MIRË




| | KOMUNA | NËN-INDEKSI 1: BARRIERAT E HYRJES |
|---|---|---|
| 1 | Kllokot | 9.9 |
| 2 | Mamushë | 9.5 |
| 3 | Novobërdë | 9.0 |
| 4 | Pejë | 9.0 |
| 5 | Podujevë | 8.8 |
| 6 | Graçanicë | 8.5 |
| 7 | Prishtinë | 8.5 |

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.

Figura 4.1.1

# TË GJITHA KOMUNAT PËRFORMUESE

| MUNICIPALITY | NËN-INDEKSI 1: BARRIERAT E HYRJES |
|---|---|
| Kllokot | 9.9 |
| Mamushë | 9.5 |
| Novobërdë | 9.0 |
| Pejë | 9.0 |
| Podujevë | 8.8 |
| Graçanicë | 8.5 |
| Prishtinë | 8.5 |
| Junik | 8.5 |
| Rahovec | 8.4 |
| Gjakovë | 8.3 |
| Shtime | 8.2 |
| Suharekë | 8.1 |
| Hani i Elezit | 8.1 |
| Lipjan | 8.1 |
| Leposaviq | 8.0 |
| Kamenicë | 7.9 |
| Partesh | 7.9 |
| Mitrovicë | 7.9 |
| Ranillug | 7.9 |
| Skenderaj | 7.8 |
| Dragash | 7.8 |
| Viti | 7.7 |
| Fushë Kosovo | 7.7 |
| Obiliq | 7.7 |
| Mitrovica e Veriut | 7.7 |
| Zveçan | 7.6 |
| Istog | 7.5 |
| Kaçanik | 7.5 |
| Gjilan | 7.4 |
| Zubin Potok | 7.3 |
| Shtërpcë | 7.1 |
| Prizren | 7.1 |
| Vushtrri | 7.1 |
| Ferizaj | 7.0 |
| Gllogovc | 6.9 |
| Klinë | 6.8 |
| Deçan | 6.4 |
| Malishevë | 6.3 |

Nën-indeksi i barrierave për hyrje në biznes paraqet kohën dhe dokumentet që kërkohen për bizneset për t'u futur në treg, shkallën në të cilën bizneset i shohin këto kosto si barriera dhe shkallën në të cilën bizneset konsiderojnë se konkurrenca e tyre është e përfshirë ne ekonomi joformale.

Në nivel kombëtar, numri i ditëve që bizneseve ju duhet për të mbledhur të gjitha dokumentet e kërkuara dhe për të përfunduar procedurën e regjistrimit të biznesit është 7 ditë, ndërsa numri i dokumenteve të kërkuara, pavarësisht nga lloji i biznesit është 4 ditë. Pra, mesatarisht, krijimi i një biznesi është mjaft i shpejtë dhe efikas. Tabela 5.1.2 dhe diskutimi që vijon tregon se ka shumë komuna ku procesi zgjat më tepër (për shembull në Podujevë, procesi zgjat deri në mesatarisht 83 ditë në vit).

Ekonomia joformale, nga ana tjetër, siç diskutohet në pjesën e sfondit të raportit, përbën një pengesë të madhe për një konkurrencë të ndershme në Kosovë. Në këtë mënyrë, për të ruajtur konkurrencën e tyre, bizneset, në një mjedis ku informaliteti është deri në 35 për qind të PBB-së, bizneset shtyhen të angazhohen në një lloj të ekonomisë joformale. Mesatarisht, 62.4 përqind e bizneseve mendojnë se konkurrentët e tyre janë të angazhuar në ekonomi joformale.

Në një nivel më i zbërthyer i nën-indeksit është paraqitur në Tabelën 5.1.3, ku shihet se dallimet e rezultateve të komponentëve të ndryshëm të nën-indeksit të barrierave të hyrjes në treg është më i madh. Numri i ditëve për hapjen e një biznesi varion nga 2 ditë në Novobërdë në 88 në Podujevë. Numri i dokumenteve të kërkuara për regjistrimin e biznesit varion ndërmjet mesatarisht 1-2 dokumenteve në Novobërdë, Partesh dhe Mamushë, në mesatarisht 14 dokumente në Han të Elezit.

TABELA 4.1.2 Komponentët e nën-indeksit të barrierave të hyrjes në biznes në nivel kombëtar



*BURIMI:*
ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.

| NËN-INDEKSI: BARRIERAT E HYRJES NË BIZNES | MESATARJA NË NIVEL KOMBËTAR |
|---|---|
| Sa ka zgjatur procesi i fillimit të biznesit? (numri i ditëve) | 7.0 |
| Sa dokumente kërkohen për regjistrimin e biznesit? (numër) | 4.0 |
| A mendoni se konkurrentët tuaj janë të angazhuar në ekonominë joformale? | 62.4% |
| A e konsideroni numrin e dokumenteve të kërkuara për hapjen e biznesit si pengesë? (% po) | 20.6% |

## TABELA 4.1.3 Nën-indeksi i barrierave të hyrjes për secilin rajon dhe komunë

| | | # i ditëve për të hapur biznesin | # i dokumenteve për të hapur biznesin | konkurrentët e përfshirë në aktivitete informale | # i dokumenteve për të hapur biznesin është pengesë |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Ferizaj** | **19.0** | **7.3** | **68%** | **20.3%** |
| | Ferizaj | 12.7 | 4.1 | 84% | 35.7% |
| | Hani i Elezit | 12.9 | 14.3 | 44% | 11.1% |
| | Kaçanik | 17.0 | 4.2 | 73% | 20.8% |
| | Shtërpcë | 36.0 | 5.0 | 83% | 11.1% |
| | Shtime | 16.7 | 13.7 | 36% | 13.9% |
| **Rajoni** | **Gjakovë** | **15.1** | **3.1** | **64%** | **33.9%** |
| | Gjakovë | 13.7 | 3.3 | 57% | 6.0% |
| | Junik | 45.4 | 5.2 | 13% | 12.8% |
| | Malishevë | 4.9 | 2.2 | 91% | 68.9% |
| **Rajoni** | **Gjilan** | 10.1 | 3.9 | 61% | 15.3% |
| | Gjilan | 15.4 | 4.5 | 94% | 9.7% |
| | Kamenicë | 19.0 | 7.4 | 49% | 24.0% |
| | Kllokot | 5.5 | 2.3 | 0% | 0.0% |
| | Novobërdë | 2.0 | 1.1 | 33% | 9.4% |
| | Partesh | 4.7 | 1.8 | 63% | 27.6% |
| | Ranillug | 3.2 | 1.7 | 63% | 30.0% |
| | Viti | 10.3 | 4.8 | 75% | 12.4% |
| **Rajoni** | **Pejë** | **14.2** | **5.6** | **71%** | **28.5%** |
| | Deçan | 31.5 | 5.9 | 84% | 44.2% |
| | Istog | 17.9 | 5.5 | 77% | 17.5% |
| | Klinë | 5.0 | 6.7 | 90% | 40.2% |
| | Pejë | 2.4 | 4.0 | 31% | 10.6% |

| | | # i ditëve për të hapur biznesin | # i dokumenteve për të hapur biznesin | konkurrentët e përfshirë në aktivitete informale | # i dokumenteve për të hapur biznesin është pengesë |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Mitrovica** | **19.0** | **5.0** | **59%** | **28.6%** |
| | Leposaviq | 15.1 | 4.7 | 67% | 6.7% |
| | Mitrovica | 37.1 | 3.9 | 36% | 29.3% |
| | Mitrovica e Veriut | 16.4 | 6.5 | 53% | 30.7% |
| | Skenderaj | 7.8 | 5.3 | 74% | 12.5% |
| | Vushtrri | 6.2 | 4.5 | 70% | 50.0% |
| | Zubin Potok | 34.0 | 5.5 | 58% | 28.6% |
| | Zveçan | 12.8 | 5.3 | 70% | 21.6% |
| **Rajoni** | **Prishtinë** | **24.3** | **4.5** | **57%** | **15.1%** |
| | Gllogoc | 7.1 | 3.1 | 88% | 38.7% |
| | Fushë Kosovë | 22.6 | 3.4 | 86% | 1.4% |
| | Graçanicë | 19.1 | 6.5 | 29% | 12.9% |
| | Lipjan | 6.0 | 3.7 | 67% | 11.5% |
| | Obiliq | 21.3 | 4.2 | 71% | 15.4% |
| | Podujevë | 83.3 | 4.2 | 17% | 7.4% |
| | Prishtinë | 15.7 | 5.6 | 33% | 15.0% |
| **Rajoni** | **Prizren** | **10.8** | **3.6** | **61%** | **12.7%** |
| | Dragash | 3.6 | 3.6 | 85% | 8.3% |
| | Mamushë | 2.1 | 1.8 | 19% | 2.7% |
| | Prizren | 20.8 | 3.0 | 81% | 28.6% |
| | Rahovec | 14.2 | 4.9 | 37% | 17.2% |
| | Suharekë | 9.1 | 4.1 | 66% | 5.2% |

Për të parë nëse dallojnë barrierat për hyrje në komuna me madhësi të ndryshme, ne kemi ndarë komunat në tri grupe: (i) ato që kanë me më pak se 50 mijë banorë, (ii) 50-80 mijë banorë, dhe (iii) komunat me më shumë se 80 mijë banorë. Sipas këtij klasifikimi, komunat me më shumë se 80 mijë banorë kanë më pak pengesa për hyrje në biznes.

TABELA4.1.4 Nën-indeksi i barrierave të hyrjes në treg në bazë të madhësisë së komunave

| MADHËSIA E KOMUNAVE | REZULTATI |
|---|---|
| 0 - 50 000 banorë | 7.9 |
| 50 000 – 80 0000 banorë | 7.6 |
| Mbi 80 000 banorë | 8.1 |

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.



Nën-indeksi i IKK-së për barrierat në hyrje vlerëson pengesat që kanë bizneset duke u fokusuar veçanërisht në barrierat që shfaqen në nivel lokal. Dallimet në barrierat e hyrjes midis komunave vlerësohen nga dy perspektiva kryesore: koha dhe dokumentet e nevojshme për regjistrimin e një biznesi dhe barrierat e hyrjes.

# NËN-INDEKSI 2: TRANSPARENCA

Transparenca është një komponent thelbësor i qeverisjes demokratike në nivel kombëtar dhe lokal. Institucionet qeveritare transparente, ku janë të pranishëm mekanizmat e llogaridhënies, ofrojnë bazë solide për zhvillimin socio-ekonomik të një vendi. Për më tepër, shpërndarja e informacionit publik është një parakusht që qytetarët të ushtrojnë të drejtat e tyre individuale. Kosova ende po përpiqet të ndërtojë institucione transparente dhe të përgjegjshme që do të siguronin një nivel më të lartë të llogaridhënies ndaj qytetarëve të saj. Megjithatë, sipas një raporti të fundit të botuar nga organizata mbikëqyrëse Transparency International, Kosova ka përmirësuar renditjen në indeksin e korrupsionit për tre pikë ose 10 vende në renditjen botërore që nga viti 2016.[7] Ky përmirësim mund t'i atribuohet përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve qeveritare, donatorëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile. Aktualisht, ka disa iniciativa të vazhdueshme që kanë për qëllim përmirësimin e transparencës në institucionet publike, kryesisht në sistemin gjyqësor.[8]

Nën-indeksi i IKK-së mbi transparencën kap qasjen e përgjithshme të biznesit në informata dhe dokumente të ndryshme publike në nivel lokal. Ky nën-indeks përbëhet nga disa tregues lidhur me perceptimin e biznesit lidhur me qasjen në buxhetin komunal, tenderët publikë, informacionin mbi licencat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me procedurat operative të lidhura me biznesin.

Tabela e mëposhtme rendit komunat me performancë më të lartë sa i përket transparencës. Komuna e Lipjanit ka marrë rezultatin më të lartë të indeksit prej 7.1 nga 10, ndjekur nga Gjakova (6.9), Prishtina (6.9), Hani i Elezit (6.7), Zubin Potoku (6.4) dhe kështu me radhë .

Nga ana tjetër, siç tregohet më poshtë në figurën 4.2.1, në fund të listës renditen Ferizaji (3.6), Dragashi (3.7) dhe Klina (4.1).

7 Transparency International (2017). Indeksi i perceptimit të korrupsionit. Kosovë. I qasshëm online. https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017

8 USAID. Justice System Strengthening Program. News and information. I qasshëm online. https://www.usaid.gov/kosovo/fact-sheets/justice-system-strengthening-program




Tabela 4.2.1

# KOMUNAT ME PERFORMANCË MË TË MIRË




| | KOMUNA | NËN-INDEKSI 2: TRANSPARENCA |
|---|---|---|
| 1 | Lipjan | 7.1 |
| 2 | Gjakovë | 6.9 |
| 3 | Prishtinë | 6.7 |
| 4 | Hani i Elezit | 6.5 |
| 5 | Zubin Potok | 6.4 |
| 6 | Malishevë | 6.3 |
| 7 | Kaçanik | 6.3 |

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.

Figura 4.2.1

# TË GJITHA KOMUNAT PËRFORMUESE

| KOMUNA | NËN-INDEKSI 2: TRANSPARENCA |
|---|---|
| Lipjan | 7.1 |
| Gjakovë | 6.9 |
| Prishtinë | 6.7 |
| Hani i Elezit | 6.5 |
| Zubin Potok | 6.4 |
| Malishevë | 6.3 |
| Kaçanik | 6.3 |
| Junik | 6.2 |
| Viti | 6.2 |
| Istog | 6.0 |
| Shtime | 5.9 |
| Podujevë | 5.9 |
| Obiliq | 5.9 |
| Gllogovc | 5.9 |
| Partesh | 5.9 |
| Rahovec | 5.7 |
| Prizren | 5.5 |
| Mitrovicë | 5.4 |
| Deçan | 5.3 |
| Vushtrri | 5.2 |
| Graçanicë | 5.1 |
| Novobërdë | 5.1 |
| Leposaviq | 5.0 |
| Suharekë | 4.9 |
| Shtërpcë | 4.8 |
| Skenderaj | 4.7 |
| Mitrovica e Veriut | 4.7 |
| Pejë | 4.7 |
| Ranillug | 4.5 |
| Gjilan | 4.5 |
| Kllokot | 4.5 |
| Fushë Kosovo | 4.5 |
| Mamushë | 4.4 |
| Kamenicë | 4.2 |
| Zvečan | 4.2 |
| Klinë | 4.1 |
| Dragash | 3.7 |
| Ferizaj | 3.6 |

Informatat mbi treguesit e transparencës janë mbledhur përmes katër pyetjeve të ndryshme (shih tabelën 4.2.2) rreth perceptimit të bizneseve që kanë të bëjnë me transparencën e qeverive lokale. Më konkretisht, bizneseve u është kërkuar që të vlerësojnë secilin tregues në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 tregon mungesë të qasje, dhe 5 qasje të lehtë në informacion. Në nivel të përgjithshëm, rezultati mesatar i qasjes në informata mbi buxhetin komunal ishte 2.9 ndërsa qasja në informata lidhur me rregulloret vendore lidhur me biznesin ishte 3.1. Paksa më e kënaqshme është niveli i transparencës kur bëhet fjalë për informacion mbi licencat e biznesit lokal: rezultati mesatar në nivel kombëtar ishte 3.2 pikë të intensitet. Nga ana tjetër, rezultati më i ulët, sa i përket treguesve të transparencës, ka marrë perceptimi i bizneseve në Kosovë lidhur me qasjen në informata mbi tenderët publikë në nivel lokal (tabela 4.2.3).

Në një nivel më të zbërthyer, siç përshkruhet në Tabelën 4.2.3,[9] mund të shohim se bizneset në rajonet e Prishtinës dhe Gjakovës kanë vlerësuar treguesit e transparencës mesatarisht më lartë në krahasim me rajonet e tjera. Niveli më i ulët i transparencës është më i dukshëm në rajonet e Prizrenit, Gjilanit dhe Pejës. Informacioni mbi aktivitetin e prokurimit publik lokal duket të jetë shqetësimi më i zakonshëm i bizneseve lidhur me transparencën në nivel lokal. Kjo është veçanërisht e dukshme në rajonin e Pejës, përkatësisht në komunën e Pejës, Deçanit, Klinës dhe Istogut.

## TABELA 4.2.2 Komponentët e nën-indeksit të transparencës në nivel kombëtar



*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.

| NËN-INDEKSI: TRANSPARENCA | MESATARJA NË NIVEL KOMBËTAR |
|---|---|
| Si e vlerësoni qasjen në informata mbi buxhetin komunal? | 2.9 |
| Si e vlerësoni qasjen në informata rreth rregulloreve lokale? | 3.1 |
| Si e vlerësoni qasjen në informacion në lidhje me licencat lokale për funksionimin e biznesit? | 3.2 |
| Si do ta vlerësonit qasjen në informata lidhur me tenderët e ardhshëm që do të shpallen nga komuna juaj? | 2.6 |

9 Katrorët e ngjyrosura me të kuqe tregojnë nivel të ulët të transparencës (rezultati i intensitetit është më i vogël se 2,75, ose kuartili i parë), ndërsa katroret në të gjelbër tregojnë nivel më të lartë të transparencës (rezultati i intensitetit është më i lartë se 3,25, ose kuartali i tretë).

## Table 4.2.3 Transparency sub-index for each region and municipality

| | | *Nën-indeksi i transpar-encës për secilin rajon dhe komunë* | *Access on information about local regulations* | Access on information regarding local business licenses for business operation | *Access on information regarding the upcoming tenders at local level* |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Ferizaj** | **2.9** | **3.2** | **3.0** | **2.6** |
| | Ferizaj | 2.1 | 2.3 | 2.3 | 2.0 |
| | Hani i Elezit | 3.4 | 3.5 | 3.4 | 3.5 |
| | Kaçanik | 3.4 | 3.6 | 3.8 | 2.5 |
| | Shtërpcë | 2.6 | 3.3 | 2.6 | 2.4 |
| | Shtime | 3.2 | 3.2 | 3.2 | 3.1 |
| **Rajoni** | **Gjakovë** | **3.6** | **3.5** | **3.6** | **3.2** |
| | Gjakovë | 3.7 | 3.7 | 4.1 | 2.9 |
| | Junik | 3.3 | 3.3 | 3.3 | 3.4 |
| | Malishevë | 3.5 | 3.4 | 3.2 | 3.3 |
| **Rajoni** | Gjilan | **2.6** | **3.0** | **2.9** | **2.5** |
| | Gjilan | 2.7 | 2.8 | 2.7 | 2.1 |
| | Kamenicë | 2.6 | 2.6 | 2.5 | 2.0 |
| | Kllokot | 2.5 | 2.5 | 2.6 | 2.7 |
| | Novobërdë | 3.0 | 2.8 | 2.8 | 2.8 |
| | Partesh | 3.1 | 3.2 | 3.2 | 3.2 |
| | Ranillug | 2.6 | 2.6 | 2.5 | 2.6 |
| | Viti | 2.3 | 3.9 | 3.9 | 3.1 |
| **Rajoni** | **Pejë** | **2.7** | **3.1** | **3.1** | **2.3** |
| | Deçan | 2.3 | 3.4 | 3.6 | 2.3 |
| | Istog | 3.2 | 3.5 | 3.4 | 2.7 |
| | Klinë | 2.4 | 2.6 | 2.7 | 1.9 |
| | Pejë | 2.7 | 2.8 | 2.7 | 2.3 |

| | | *Qasja në informata mbi buxhetin komunal* | *Qasja në informata rreth rregulloreve lokale* | Qasja në informata lidhur me licencat lokale për funksionimin e biznesit | *Qasja në informata lidhur me tenderët e ardhshëm në nivel lokal* |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Mitrovica** | **2.7** | **2.9** | **3.2** | **2.5** |
| | Leposaviq | 2.2 | 2.3 | 4.1 | 2.5 |
| | Mitrovica | 3.0 | 3.0 | 3.0 | 2.9 |
| | Mitrovica e Veriut | 2.4 | 2.5 | 3.5 | 2.2 |
| | Skenderaj | 2.6 | 2.9 | 2.9 | 2.3 |
| | Vushtrri | 2.7 | 3.2 | 3.2 | 2.4 |
| | Zubin Potok | 3.4 | 3.4 | 3.5 | 3.4 |
| | Zveçan | 2.1 | 2.2 | 3.3 | 2.0 |
| **Rajoni** | **Prishtinë** | **3.3** | **3.4** | **3.4** | **2.8** |
| | Gllogoc | 3.2 | 3.3 | 3.1 | 3.1 |
| | Fushe Kosovë | 2.5 | 2.7 | 2.9 | 2.0 |
| | Graçanicë | 2.6 | 3.0 | 3.4 | 2.3 |
| | Lipjan | 3.8 | 4.0 | 4.0 | 3.0 |
| | Obiliq | 3.2 | 3.3 | 3.5 | 2.6 |
| | Podujevë | 3.4 | 3.5 | 3.2 | 2.6 |
| | Prishtinë | 3.7 | 3.5 | 3.5 | 3.5 |
| **Rajoni** | **Prizren** | **2.6** | **2.7** | **3.0** | **2.6** |
| | Dragash | 2.3 | 2.4 | 2.3 | 1.8 |
| | Mamushë | 2.6 | 2.4 | 2.7 | 2.3 |
| | Prizren | 2.7 | 2.8 | 3.6 | 2.9 |
| | Rahovec | 3.1 | 3.1 | 3.1 | 3.1 |
| | Suharekë | 2.5 | 2.5 | 3.1 | 2.9 |

Së fundi, për të parë nëse ka ndonjë dallim në nivelin e transparencës në komuna me madhësi të ndryshme, kemi ndarë komunat në tri grupe: (i) ato që kanë më pak se 50 mijë banorë, (ii) 50-80 mijë banorë, dhe (iii) komunat me më shumë se 80 mijë banorë. Sipas këtij klasifikimi, komunat e mesme, pra mes 50 dhe 80 mijë banorë kanë një nivel më të lartë të transparencës.

TABELA 4.2.4 Nën-indeksi i transparencës në bazë të madhësisë së komunave

| MADHËSIA E KOMUNAVE | REZULTATI |
|---|---|
| 0-50 000 banorë | 5.2 |
| 50 000 – 80 0000 banorë | 5.7 |
| Mbi 80 000 banorë | 5.4 |

*BURIMI*: ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.



Nën-indeksi i IKK-së mbi transparencën kap qasjen e përgjithshme të biznesit në informata dhe dokumente të ndryshme publike në nivel lokal. Ky nën-indeks përbëhet nga disa tregues lidhur me perceptimin e biznesit lidhur me qasjen në buxhetin komunal, tenderët publikë, informacionin mbi licencat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me procedurat operative të lidhura me biznesin.

# NËN-INDEKSI 3: PJESËMARRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA

Nën-indeksi 3 tregon masën në të cilën bizneset në Kosovë marrin pjesë në vendimmarrjen vendore dhe masën në të cilën ato konsiderojnë se qeveria është e hapur për të bashkëpunuar me ta drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta. Një formë e zakonshme e ndërveprimit midis institucioneve të qeverisjes dhe bizneseve në nivel lokal janë debate publike. Komunave u kërkohet me ligj që të takohen me bizneset dy herë në vit[10] për të diskutuar ndryshimet e kuadrit rregullator, planet strategjike dhe qeverisjen. Kjo është një masë që jo vetëm promovon interesat e të dyja palëve, por gjithashtu barazon pritjet e secilës anë dhe siguron se ciklet e biznesit janë më me pak ndikime negative.  Në këtë drejtim, pritjet janë të rëndësishme nga perspektiva e biznesit, në mënyrë që tu lejohet atyre që të ndërtojnë dhe zbatojnë strategji afatgjata për rritje.

Nën-indeksi 3 i IKK-së për pjesëmarrje dhe parashikueshmëri fokusohet në nxjerrjen e një mase që vlerëson shkallën e bashkëpunimit të administratës komunale me bizneset. Dy dimensionet e vlerësuara në kuadër të këtij nën-indeksi janë: (1) shkalla në të cilën komunat përfshijnë bizneset në debate publike dhe vendimmarrje, dhe (2) sa kanë besim bizneset se mund të parashikojnë ndryshimet e politikave publike apo rregulloreve.

Figura 4.3.1 tregon rezultatet e nën-indeksit 3 për të gjitha komunat në Kosovë. Në përgjithësi, ky është një nga nën-indekset që pasqyron një situatë më kritike krahasuar me nën-indekset tjera në përgjithësi. Në shkallë prej 1-10, asnjë nga komunat nuk arrin një indeks më të madh se 6.6 (Juniku). Lipjani është performuesi tjetër më i mirë me një rezultat prej 6.0. Pjesa tjetër e komunave që renditen lartë janë: Zubin Potoku, Prishtina, Obiliqi, Vitia, Hani i Elezit dhe Ferizaji. Megjithatë, ende shumica e këtyre komunave arrijnë një rezultat shumë të ulët (nga 5.5 për Zubin Potokun në 4.7 për Hanin e Elezit dhe Ferizajn). 30 komunat e mbetura arrijnë rezultate edhe më të ulëta, ku 20 prej komunave kanë një rezultat prej 4.0 ose më pak.

Kështu, mund të konkludojmë se nën-indeksi i pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë pasqyron një mjedis të qeverisjes lokale ku bizneset nuk janë të angazhuara ose pjesëmarrëse në udhëheqjen e hartimit të politikave. Kjo gjithashtu manifestohet edhe përmes faktit se bizneset që nuk janë në gjendje të parashikojnë ndryshimet e mundshme në rregulloret ose politikat publike, ose shkallën e zbatimit të tyre.

10 Kuvendi i Kosovës (2008). Ligji mbi qeverisjen lokale, Ligji Nr. 03/L-040.




Tabela 4.3.1

# KOMUNAT ME PERFORMANCË MË TË MIRË




| | KOMUNA | NËN-INDEKSI 3: PJESËMARRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA |
|---|---|---|
| 1 | Junik | 6.6 |
| 2 | Lipjan | 6.0 |
| 3 | Zubin Potok | 5.5 |
| 4 | Prishtinë | 5.3 |
| 5 | Obiliq | 5.0 |
| 6 | Viti | 4.8 |
| 7 | Hani i Elezit | 4.7 |
| 8 | Ferizaj | 4.7 |

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.

Figura 4.3.1

# TË GJITHA KOMUNAT PËRFORMUESE

| KOMUNA | NËN-INDEKSI 3: PJESËMARRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA |
|---|---|
| Junik | 6.6 |
| Lipjan | 6.0 |
| Zubin Potok | 5.5 |
| Prishtinë | 5.3 |
| Obiliq | 5.0 |
| Viti | 4.8 |
| Hani i Elezit | 4.7 |
| Ferizaj | 4.7 |
| Partesh | 4.6 |
| Shtërpcë | 4.6 |
| Deçan | 4.5 |
| Shtime | 4.5 |
| Istog | 4.4 |
| Rahovec | 4.3 |
| Prizren | 4.2 |
| Skenderaj | 4.2 |
| Suharekë | 4.1 |
| Novobërdëo | 4.1 |
| Pejë | 4.0 |
| Podujevë | 4.0 |
| Gjilan | 3.9 |
| Kaçanik | 3.9 |
| Graçanicë | 3.9 |
| Malishevë | 3.8 |
| Kamenicë | 3.7 |
| Ranillug | 3.7 |
| Mamushë | 3.6 |
| Gjakovë | 3.6 |
| Vushtrri | 3.5 |
| Gllogovc | 3.5 |
| Mitrovicë | 3.4 |
| Klinë | 3.4 |
| Klokot/Klokot/Kllokot | 2.9 |
| Fushë Kosovë | 2.9 |
| Mitrovicë e Veriut | 2.8 |
| Zveçan | 2.8 |
| Dragash | 2.7 |
| Leposaviq | 2.7 |

Renditja mesatare e pyetjeve përbërëse të nën-indeksit 3 është paraqitur në tabelën 4.3.2. Mesataret kombëtare paraqesin përgjigjet e anketës, në një shkallë prej 1 deri në 5, duke shpjeguar frekuencën, ku 1 paraqet asnjëherë ndërsa 5 paraqet gjithmonë.

Mesatarisht, në nivel kombëtar, bizneset kanë ranguar me 2.5 saktësinë kohore të informacionit nga institucionet nga maksimumi prej 5. Ndërsa pjesëmarrja aktuale në debatet publike nga bizneset ka marrë pikë më të ulëta prej 1.8. Pjesa tjetër e pyetjeve të komponentëve të nën-indeksit 3 gjithashtu shënon një nivel të ulët midis 2.2 dhe 2.9.

Pra, ekziston performancë e ulët e administratës komunale në bashkëpunimin me bizneset dhe në përafrimin e interesave të bizneseve me veprimet komunale që prekin bizneset.

Një nivel më i zbërthyer është paraqitur në Tabelën 4.3.3, ku shihen dallimet në rezultate të komponentëve të nën-indeksit 3 të IKK-së, atë të pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë, për çdo rajon dhe komunë. Rezultatet e performancës janë të ulëta në të gjithë tabelën dhe sinjalizojnë një rezultat të unifikuar për indeksin pavarësisht nga rajoni.

## TABELA 4.3.2 Komponentët e nën-indeksit të pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë në nivel kombëtar

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE

| NËN-INDEKSI: PJESËMARRJA DHE PARASHIKUESHMËRIA | MESATARJA NË NIVEL KOMBËTAR SHKALLA NGA 1 DERI NË 5 |
|---|---|
| A jeni informuar me kohë për ndryshimet në rregulloret dhe udhëzimet administrative nga komuna? (1- kurrë, 5- gjithnjë) | 2.47 |
| Sa shpesh keni marrë pjesë në debatet publike që organizohen nga komuna? (1- kurrë, 5- gjithnjë) | 1.8 |
| Sa shpesh mendoni se rregulloret e reja komunale dhe udhëzimet administrative të ngritura gjatë debateve publike, mbrojnë interesat e bizneseve? (1- kurrë, 5- gjithnjë) | 2.4 |
| Sa shpesh prisni që rregulloret komunale të zbatohen? (1- kurrë, 5- gjithnjë) | 2.9 |
| A jeni informuar me kohë për debatet publike komunale lidhur me ndryshimet në politikat publike, rregullat dhe rregulloret komunale? (1- kurrë, 5- gjithnjë) | 2.2 |

## Tabela 4.3.3 Nën-indeksi i pjesëmarrjes dhe parashikueshmërisë për çdo rajon dhe komunë

| | | *saktësia kohore e informatave në lidhje me rregulloret dhe politikat e reja* | *frekuenca e debateve publike nga komunat* | *rregulloret e reja mbrojnë interesat e biznesit* | *pritjet për zbatimin e rregulloreve komunale* | *informimi me kohë në lidhje me debatet publike* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Ferizaj** | **2.7** | **2.1** | **2.4** | **3** | **2.5** |
| | Ferizaj | 2.1 | 2.5 | 2.3 | 3.5 | 2.7 |
| | Hani i Elezit | 3 | 2 | 2.9 | 3 | 2.5 |
| | Kaçanik | 3 | 1.5 | 1.9 | 2.7 | 2.4 |
| | Shtërpcë | 2.9 | 2.1 | 2.6 | 3.2 | 2.2 |
| | Shtime | 2.7 | 2.1 | 2.6 | 2.8 | 2.4 |
| **Rajoni** | **Gjakovë** | **2.4** | **1.6** | **2.7** | **3.3** | **2.1** |
| | Gjakovë | 2.1 | 1.2 | 2.2 | 3.2 | 2 |
| | Junik | 3.6 | 3.1 | 3.6 | 3.8 | 3.3 |
| | Malishevë | 2.2 | 1.3 | 2.8 | 3.2 | 1.8 |
| **Rajoni** | **Gjilan** | **2.6** | **1.9** | **2.1** | **2.9** | **2.2** |
| | Gjilan | 3.1 | 1.4 | 2 | 2.5 | 2.5 |
| | Kamenicë | 2.2 | 1.5 | 2.1 | 3.1 | 2.2 |
| | Kllokot | 2.6 | 1.7 | 1.6 | 1.7 | 1.7 |
| | Novobërdë | 2.6 | 2.4 | 2.3 | 2.3 | 2.2 |
| | Partesh | 3.2 | 3 | 2.2 | 2.2 | 2.4 |
| | Ranillug | 2.4 | 2.4 | 2.1 | 2.1 | 2 |
| | Viti | 2.5 | 1.8 | 2.1 | 4.7 | 2.4 |
| **Rajoni** | **Pejë** | **2.5** | **1.7** | **2.3** | **3.1** | **2.3** |
| | Deçan | 3.3 | 1.5 | 2.2 | 2.9 | 2.9 |
| | Istog | 2.4 | 2 | 2.4 | 3.1 | 2.6 |
| | Klinë | 1.8 | 1.5 | 1.9 | 3.3 | 1.7 |
| | Pejë | 2.4 | 1.7 | 2.7 | 3.1 | 1.9 |

| | | *saktësia kohore e informatave në lidhje me rreg-ulloret dhe politikat e reja* | *frekuenca e debateve publike nga komunat* | *rregulloret e reja mbrojnë interesat e biznesit* | *pritjet për zbatimin e rregulloreve komunale* | *informimi me kohë në lidhje me debatet publike* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rajoni** | **Mitrovica** | **2.1** | **1.7** | **2.2** | **2.7** | **2** |
| | Leposaviq | 1.9 | 1.4 | 1.9 | 2.2 | 1.5 |
| | Mitrovica | 2.2 | 1.9 | 1.4 | 2.8 | 2 |
| | Mitrovica e Veriut | 1.9 | 1.4 | 2 | 2.3 | 1.5 |
| | Skenderaj | 2.4 | 1.9 | 2.6 | 2.8 | 2.4 |
| | Vushtrri | 1.7 | 1.5 | 2.6 | 2.9 | 1.8 |
| | Zubin Potok | 3 | 3 | 3.1 | 3.1 | 3 |
| | Zveçan | 1.7 | 1.4 | 2.2 | 2.3 | 1.5 |
| **Rajoni** | **Prishtinë** | **2.6** | **1.7** | **2.7** | **3.1** | **2.5** |
| | Gllogoc | 1.8 | 1.2 | 2.7 | 3.1 | 1.8 |
| | Fushë Kosovë | 1.5 | 1.2 | 2.3 | 3 | 1.3 |
| | Graçanicë | 2.5 | 1.5 | 2.4 | 2.6 | 2.3 |
| | Lipjan | 3.7 | 2 | 3.4 | 3.8 | 3.2 |
| | Obiliq | 2.9 | 2.2 | 2.9 | 3 | 2.8 |
| | Podujevë | 2.5 | 1.5 | 2.3 | 2.6 | 2.7 |
| | Prishtinë | 3.3 | 2.1 | 2.9 | 3.6 | 2.8 |
| **Rajoni** | **Prizren** | **2.2** | **1.6** | **2.4** | **2.9** | **2.2** |
| | Dragash | 1.6 | 1.4 | 1.9 | 2.5 | 1.4 |
| | Prishtinë | 3.8 | 2.67 | 2.5 | 95.9% | 4.63 | 11.69 | 4.6 |
| Rajoni | **Prizren** | 3.3 | 3.26 | 3.0 | 65.9% | 4.76 | 10.46 | 4.1 |
| | Dragash | 2.8 | 3.2 | 2.2 | 19.8% | 4.3 | 21.7 | 2.4 |
| | Mamushë | 2.7 | 2.3 | 2.3 | 2.9% | | | |
| | Prizren | 3.4 | 3.5 | 3.0 | 95.0% | 7.1 | 7.4 | 4.6 |
| | Rahovec | 3.6 | 3.6 | 3.7 | 90.2% | 2.8 | 5.4 | 3.9 |
| | Suharekë | 4.0 | 3.4 | 3.7 | 96.0% | 2.9 | 2.5 | 4.5 |

Së fundi, madhësia e komunave duket të jetë pozitivisht e ndërlidhur me cilësinë e infrastrukturës lokale. Kur i ndajmë komunat në tre nën-grupe sipas madhësisë së tyre, rezultati mesatar në infrastrukturën lokale është pak më i lartë në komunat me më shumë se 50 mijë banorë krahasuar me ato me më pak se 50 mijë (figura 4.8.2).

TABELA 4.8.4 Nën-indeksi i infrastrukturës lokale në bazë të madhësisë së komunave

| MADHËSIA E KOMUNAVE | REZULTATI |
|---|---|
| 0-50 000 banorë | 6.4 |
| 50 000 – 80 0000 banorë | 6.7 |
| Mbi 80 000 banorë | 6.7 |

*BURIMI:* ANKETA 2018, LLOGARITJET E AUTORËVE.



Përveç cilësisë së rrugëve, nën-indeksi i IKK-së për infrastrukturën lokale vlerëson edhe cilësinë e sistemit të kanalizimit, mirëmbajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave, qasjen në rrjetin publik të furnizimit me ujë, si dhe furnizimin e rregullt të energjisë dhe ujit. Ai gjithashtu siguron informacion mbi shkallën e arkëtimit nga konsumatorët për shërbimet e furnizimit me ujë.

# 5 IKK I PESHUAR NË BAZË TË POLITIKAVE PUBLIKE

IKK i peshuar në bazë të politikave publike ka përdorur pesha më të mëdha për katër nga nën-indekset të cilët janë evidentuar se kanë ndikim më të rëndësishëm siç është shpjeguar në seksionin e metodologjisë së raportit. Katër indekset më të rëndësishme në Kosovë janë: **(1) Transparenca, (2) Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria, (3) Kostot kohore dhe (4) Taksat dhe tarifat.** Krahasuar me IKK-në e pa ponderuar ku secili prej nën-indekseve ka një peshë të barabartë në rezultatin e përgjithshëm, IKK e peshuar ka pesha të rrumbullaksuara prej 15 përqind të secilit prej këtyre katër nën-indekseve, krahasuar me nën-indekset më pak të rëndësishëm që kanë një peshë të rrumbullaksuara prej 10 përqind.

Tabela 6.1 Paraqet peshat e nxjerra nga analiza e të dhënave për secilin nën-indeks, si dhe peshat e rrumbullaksuara të përdorura për gjenerimin e IKK-së së peshuar në bazë të politikave publike

Përdorimi i peshave të politikave publike ndryshon paksa renditjen e komunave me rezultat më të mirë. Tabelat 5.2 dhe 5.3 tregojnë se me përjashtim të Lipjanit, pozitat e komunave tjera ndryshohen. Suhareka gjithashtu nuk është më në listën e 10 komunave që prijnë me rangim, përderisa kësaj liste i shtohet Parteshi. Dhjetë komunat që rangohen më së larti janë gjithashtu pjesë e kuartilit të tretë ose të sipërm të listës së plotë të komunave. Grafiku 1 tregon IKK-në e peshuar në bazë të politikave publike, për secilën komunë.

TABELA 5.1 Nën-indekset e IKK-së, në nivel kombëtarë

| | NËN-INDEKSI I IKK-SË | PESHA NGA ANALIZA | PESHA E RRUMBULLAKSUAR |
|---|---|---|---|
| 01 | Barrierat e hyrjes në biznes | 10.2% | 10% |
| 02 | Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria | 13.3% | 15% |
| 03 | Transparenca | 16.9% | 15% |
| 04 | Kostot kohore | 15.2% | 15% |
| 05 | Taksat dhe tarifat | 15.2% | 15% |
| 06 | Administrata komunale | 11.4% | 10% |
| 07 | Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese | 9.9% | 10% |
| 08 | Infrastruktura komunale | 7.9% | 10% |

0.0-1.0 | 1.0-2.0 | 2.0-3.0 | 3.0-4.0 | 4.0-5.0 | 5.0-6.0 | 6.0-7.0 | 7.0-8.0 | 8.0-9.0 | 9.0-10.0

## TABELA 5.2 IKK – i papeshuar

| | KOMUNA | IKK |
|---|---|---|
| 1 | Lipjan | 7.0 |
| 2 | Rahovec | 6.8 |
| 3 | Viti | 6.6 |
| 4 | Junik | 6.6 |
| 5 | Hani i Elezit | 6.5 |
| 6 | Gjakovë | 6.5 |
| 7 | Podujevë | 6.3 |
| 8 | Obiliq | 6.3 |
| 9 | Prishtinë | 6.3 |
| 10 | Suharekë | 6.3 |

## TABELA 5.3 IKK – peshuar në bazë të politikave publike

| | KOMUNA | IKK |
|---|---|---|
| 1 | Lipjan | 6.4 |
| 2 | Junik | 6.0 |
| 3 | Rahovec | 6.0 |
| 4 | Viti | 6.0 |
| 5 | Gjakovë | 5.9 |
| 6 | Podujevë | 5.8 |
| 7 | Partesh | 5.8 |
| 8 | Hani i Elezit | 5.8 |
| 9 | Prishtinë | 5.7 |
| 10 | Obiliq | 5.7 |

## Figure 5.1 INDEKSI I KONKURRUESHMËRISË SË KOMUNAVE 2018 – PESHUAR NË BAZË TË RËNDËSISË SË POLITIKAVE PUBLIKE

| KOMUNA | |
|---|---|
| Lipjan | 6.40 |
| Junik | 6.03 |
| Rahovec | 6.02 |
| Viti | 6.02 |
| Fushë Kosovo | 5.87 |
| Podujevë | 5.82 |
| Partesh | 5.80 |
| Graçanicë | 5.80 |
| Prishtinë | 5.71 |
| Obilić | 5.70 |
| Istog | 5.68 |
| Novobërdë | 5.64 |
| Kaçanik | 5.59 |
| Pejë | 5.57 |
| Suharekë | 5.57 |
| Kllokot | 5.53 |
| Zubin Potok | 5.50 |
| Mamushë | 5.48 |
| Prizren | 5.48 |
| Shtime | 5.47 |
| Malishevë | 5.46 |
| Gllogovc | 5.45 |
| Skenderaj | 5.44 |
| Vushtrri | 5.37 |
| Mitrovicë | 5.31 |
| Deçan | 5.31 |
| Ranillug | 5.31 |
| Hani i Elezit | 5.30 |
| Gjilan | 5.21 |
| Kamenicë | 5.18 |
| Dragash | 5.18 |
| Gjakovë | 5.13 |
| Ferizaj | 5.13 |
| Shtërpcë | 5.03 |
| Leposaviq | 4.83 |
| Mitrovica e Veriut | 4.75 |
| Zveçan | 4.74 |
| Klinë | 4.54 |

# 6 GJETJET NGA DISKUTIMET NË GRUPE TË FOKUSUARA

Gjetjet nga diskutimet e fokus grupeve janë grupuar në vëzhgime tematike të organizuara sipas temave të mbuluara nga nën-indekset, duke bërë një përmbledhje të diskutimeve dhe kategorizimin e gjetjeve në formën e rekomandimeve për komunat. Rezultati i përgjithshëm i diskutimeve të këtyre fokus grupeve sugjeron se situata aktuale në sektorin privat në Kosovë është përmirësuar krahasuar me vitet e kaluara. Pjesëmarrësit në grupin e fokusit deklaruan se janë bërë shumë përmirësime në lidhje me pengesat për hyrje në biznes, gjë që mbështetet edhe nga gjetjet nga sondazhi i kryer me bizneset. Sidoqoftë, pjesëmarrësit deklaruan se Kosova është prapa vendeve të tjera në rajon dhe të njëjtit nuk ishin të kënaqur me mundësitë që bizneset aktualisht kanë. Pra mbetet ende shumë punë për tu bërë në mënyrë që të përmirësohet konkurrueshmëria e qeverisjes lokale e secilës komunë.

Posaçërisht, situata aktuale është dekurajuese kur bëhet fjalë për vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës lokale (rrugët, furnizimi me ujë, sistemi i kanalizimit dhe menaxhimi i mbeturinave). Komunat, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, duhet të jenë në gjendje që të tërheqin projekte nga qeveria qendrore dhe të konkurrojnë për huatë dhe grantet e huaja nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.

Në shumicën e komunave në Kosovë, regjistrimi i biznesit bëhet në qendrat me një ndalesë të themeluar nga ARBK me zyra të vendosura në 29 komuna të Kosovës. Kjo është vlerësuar nga zyrtarët komunalë, përfaqësuesit e OJQ-ve, por edhe nga vetë bizneset si një gjë pozitive që ka përshpejtuar kohën e regjistrimit të biznesit. Një nga gjetjet kryesore dhe në veçanti një problem i madh i identifikuar ishte mungesa e punëtorëve të kualifikuar. Një çështje tjetër e ngritur ishte numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve të kualifikuar komunal. Për më tepër, përmirësimi i shërbimeve të mbështetjes së biznesit është një masë tjetër që kërkon vëmendje të menjëhershme. Krijimi i një zyreje brenda një prej drejtorive të komunës do të përmirësonte transparencën e komunave. Kjo është theksuar nga bizneset si problem kur kontaktohen nga zyrtarët komunalë. Sa i përket marrjes së lejeve dhe licencave, përfaqësuesit e OJQ-ve deklaruan se ankesat nga bizneset kryesisht ndodhin në sektorin e ndërtimit, ku lejet shtyhen dhe ka shumë parregullsi në marrjen e lejeve të tilla. Një çështje tjetër që është përmendur është edhe nevoja për të ndryshuar Ligjin mbi Përdorimin e Tokës dhe Shkëmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale. Kjo është një nga shumë çështje që duhet të adresohet në bashkëpunim me qeverinë qendrore, pasi ajo përfshin hartimin e ligjeve të reja ose ndryshimin e ligjeve ekzistuese.

## GJETJET NGA DISKUTIMET E GRUPEVE TË FOKUSIT GJITHASHTU MUND TË PËRMBLIDHEN NË BAZË TË SHTATË RAJONEVE TË KOSOVËS DHE TË ANALIZOHEN SIPAS NËN-INDEKSEVE TË PËRDORUR NË ANKETËN E IKK-SË.

| RAJONI | GJETJET |
|---|---|
| Prishtinë | Zyrat me një ndalesë në komunat e vogla në rajonin e Prishtinës si Obiliqi dhe Fushë Kosova kanë zvogëluar kohën e regjistrimit të biznesit dhe nga përfaqësuesit komunal kjo është vlerësuar të ketë pasur një ndikim mjaft pozitiv në ecurinë e biznesit.<br><br>Komuna e Prishtinës ka identifikuar kornizën ligjore joadekuate si pengesë e cila kufizon kompetencat e komunave, e sidomos komunës së Prishtinës si qytetin më të madh në vend dhe gjithashtu si qendrën administrative, ekonomike, kulturore dhe politike të Kosovës.<br><br>Një sfidë tjetër e rëndësishme e identifikuar nga komunat e rajonit të Prishtinës ka të bëjë me procedurat administrative burokratike. Komunat në këtë rajon pretendojnë se kanë ndërmarrë veprime drejt thjeshtimit të procedurave administrative, me theks të veçantë në lëshimin e lejeve dhe licencave. |
| Prizren | Përfaqësuesit e bizneseve në këtë rajon kanë deklaruar se do të ishte e dobishme për bizneset që të kenë një zyrë të posaçme që merret vetëm me adresimin e kërkesave të biznesit. Përveç kësaj, duhet të ndërmerren hapa në përmirësimin e transparencës dhe për informimin e biznesit. Përfaqësuesit e OJQ-ve theksuan se duke ndjekur shembullin e Prishtinës dhe Gjakovës, do të ishte e dobishme të krijohen faqet e internetit paralele komunale me informacion të përditësuar dhe se publikimet e këtyre të dhënave do të ishin hapi i parë drejt përmirësimit të transparencës.<br><br>Përmirësimi i informacionit mbi subvencionet potenciale, grantet komunale dhe debatet e ardhshme publike janë evidentuar si një çështje që kërkon vëmendje të menjëhershme. |
| Gjakovë | Gjithashtu në këtë rajon theksohet mungesa e transparencës në informacionet që ofrohen nga komunat.<br><br>Në vitet 2014-2015 në Gjakovë dhe Malishevë janë hequr taksat komunale për shumicën e bizneseve, me përjashtim të disa kategorive të bizneseve (lojërave të fatit, bare dhe pikat e karburantit).<br><br>Përfaqësuesit e OJQ-ve kanë thënë se punonjësit në administratën komunale kanë njohuri të pamjaftueshme, nuk japin këshilla apo udhëzime për ndërmarrësit apo ndërmarrësit e rinj dhe nuk i njohin mirë rregulloret. |
| Pejë | Peja është një nga komunat që ka performuar shumë mirë në nën-indeksin e barrierave të hyrjes, jo vetëm lidhur me lehtësimin e regjistrimit të bizneseve, por edhe në mundësitë për fillimin dhe mirëmbajtjen e një biznesi.<br><br>Sipas diskutimit të grupeve të fokusit për rajonin e Pejës, është diskutuar një iniciativë për të formuar një grup lokal të punësimit, ku mund të marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i bizneseve. Megjithatë, kjo ende nuk është arritur.<br><br>Janë evidentuar përmirësime të konsiderueshme pasi që nga 10 procedurat e detyrueshme për regjistrim të biznesit, kjo ka rënë në 3 procedura. Kjo i atribuohet performancës së përmirësuar të zyrave të ARBK-së.<br><br>Në nën-indeksin e administratës komunale ky rajon nuk ka treguar shumë përmirësime. Pjesëmarrësit u pajtuan me gjetjet e anketës duke përmendur mungesën e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve në komuna si një nga arsyet për performancën e dobët në këtë nën-indeks. |

| RAJONI | GJETJET |
| --- | --- |
| Gjilan | Një nga rezultatet e diskutimit të këtij grupi ishte se në komunën e Gjilanit ka pasur përmirësime në lidhje me transparencën në informata, sidomos pjesëmarrja në debate publike është rritur në vitet e fundit.<br><br>Bizneset në komunën e Kamenicës informohen me telefon për ofertat dhe grantet e ardhshme. Megjithatë, komuna e Kamenicës nuk ka ndërmarrë asnjë masë në reduktimin e taksave dhe tarifave për bizneset.<br><br>Mungesa e punëtorëve të kualifikuar është një nga çështjet me të cilat ballafaqohen bizneset në këtë rajon. Shkollat profesionale ose universitetet në mbarë Kosovën nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë punëtorë të kualifikuar, duke krijuar kështu vështirësi për bizneset. |
| Feriza | Pjesëmarrësit në këtë fokus grup identifikuan dy pengesa kryesore në mjedisin afarist në këtë rajon. Transparenca e munguar në ofrimin e informacioneve për biznese dhe qasja e kufizuar e bizneseve në të dhëna dhe informacione publike.<br><br>Gjithashtu, bizneset evidentojnë pengesat në tregun e punës si një problem tjetër të madh. Bizneset në rajonin e Ferizajt deklaruan se bizneset në të shumtën e rasteve kanë vështirësi për të gjetur fuqi punëtore të kualifikuar. Posaçërisht për faktin se ky rajon është një nga më të mëdhatë në aspektin e kapaciteteve prodhuese në Kosovë. |
| Mitrovicë | Në këtë rajon, diskutimet kanë konfirmuar se komunat kanë përmirësuar marrëdhëniet me bizneset në disa nën-indekse, megjithatë ka shumë pengesa që duhet të adresohen si: transparenca në ofrimin e informacioneve për biznese dhe rritjen e shërbimeve mbështetëse për biznese. |

Rezultati i përgjithshëm i diskutimeve të këtyre fokus grupeve sugjeron se situata aktuale në sektorin privat në Kosovë është përmirësuar krahasuar me vitet e kaluara.

## MË POSHTË KEMI PARAQITUR DISA REKOMANDIME KONKRETE QË KOMUNAT MUND TË APLIKOJNË NË NJË AFAT TË SHKURTËR KOHOR.

| NËN-INDEKSET | REKOMANDIMET |
|---|---|
| KOSTOT KOHORE | Krijimi i zyrave të këshillimit të biznesit në formë të Pikave Kontaktuese Komunale në mënyrë që individët me aftësi sipërmarrëse të kenë qasje në asistencë se si të zhvillojnë idetë e reja të biznesit. |
| SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR BIZNESE | Për bizneset që operojnë, është me rëndësi të madhe t'u sigurohen atyre të gjitha udhëzimet e nevojshme për plotësimin e formularëve administrativ, pagimin e taksave dhe tarifave dhe reduktimin e procedurave të panevojshme burokratike. Këto pika të kontaktit mund të shërbejnë më tej për të ofruar ndihmë për bizneset që kanë vështirësi në hartimin e kërkesave të ndryshme në lidhje me administratën komunale. |
| ADMINISTRATA KOMUNALE | Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët komunalë. Në këtë mënyrë, zyrtarët komunalë do të ishin më të vetëdijshëm në lidhje me rëndësinë e marrëdhënieve biznes-komunë. |
| SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR BIZNESE | Të prioritizohet sektori privat dhe qeverisja komunale të shërbej si një urë midis nevojave të qytetarëve dhe biznesit.<br>Angazhim më përmbajtjesor me sektorin privat lokal.<br>Organizimi i konferencave të donatorëve ose investitorëve vendas.<br>Përfshirja e bizneseve në dëgjimet publike është i nevojshëm për komunat për të adresuar nevojat dhe kërkesat e bizneseve. |
| TRANSPARENCA | Përmirësimi i metodave të informimit të sipërmarrësve për debatet publike të organizuara nga komuna.<br>Përmirësimi i qasjes në informata lidhur me grantet e ofruara ose lidhur me ndryshimet në rregulloret që prekin bizneset. |
| ADMINISTRATA KOMUNALE | Hartimi i strategjive lokale vetëm pas konsultimeve me përfaqësuesit e sektorëve të biznesit. |
| TAKSAT DHE TARIFAT | Zvogëlimi ose heqja e disa tarifave komunale që nuk sjellin rritje të mëdha në buxhetin komunal. Kjo do të jetë e dobishme sidomos për bizneset e reja dhe bizneset e vogla. |
| TJERA | Identifikimi i përparësive krahasuese në nivel komunal ose rajonal me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë gjë që mund të tërheqë dhe mbajë firma të suksesshme. |

## TRI NËN-INDEKSET KRYESORE TË IDENTIFIKUARA NGA DISKUTIMET E FOKUS GRUPEVE NË SHTATË RAJONET E KOSOVËS QË KËRKOJNË PËRMIRËSIME TË MENJËHERSHME, PËRFSHIN:



### PRISHTINË

1. Infrastruktura lokale
2. Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria
3. Shërbimet mbështetëse të biznesit



### PRIZREN

1. Transparenca në ofrimin e informacioneve
2. Shërbimet mbështetëse për bizneset
3. Infrastruktura lokale



### PEJË

1. Shërbimet mbështetëse për bizneset
2. Transparenca në ofrimin e informacioneve
3. Administrata komunale



### FERIZAJ

1. Transparenca në ofrimin e informacioneve për biznese
2. Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria
3. Administrata komunale



### GJILAN

1. Shërbimet mbështetëse për bizneset
2. Taksat dhe tarifat
3. Infrastruktura lokale



### MITROVICË

1. Transparenca në ofrimin e informacioneve për biznese
2. Infrastruktura lokale
3. Shërbimet mbështetëse për bizneset



### GJAKOVË

1. Transparenca në ofrimin e informacioneve
2. Shërbimet mbështetëse për bizneset
3. Administrata lokale

Posaçërisht, situata aktuale është dekurajuese kur bëhet fjalë për vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës lokale (rrugët, furnizimi me ujë, sistemi i kanalizimit dhe menaxhimi i mbeturinave). Komunat, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, duhet të jenë në gjendje që të tërheqin projekte nga qeveria qendrore dhe të konkurrojnë për huatë dhe grantet e huaja nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.

# 7 METODOLOGJIA E IKK-së

Metodologjia e IKK-së bazohet në metodologjinë e standardizuar të Indeksit të Qeverisjes Ekonomike nga Fondacioni Aziatik. Indekset dhe nën-indekset e konkurrueshmërisë janë krijuar duke u bazuar në literaturën e ekonomisë së tranzicionit dhe konsultimet e ngushta me aktorët kryesorë në zhvillimin ekonomik lokal. Megjithëse detajet e metodologjive ndryshojnë pak ndërmjet shteteve ku janë krijuar indekset, të gjitha IQE-të përfshijnë elementë të njëjtë thelbësorë, dhe përfshijnë: **grumbullimin, ndërtimin dhe kalibrimin.** IKK-ja e këtij viti në Kosovë është e ankoruar në metodologjinë e USAID-it (2011) për indekset e qeverisjes, i cili kontekstualizon kuadrin e hulumtimit në mjedisin kosovar. Si i tillë, raporti lejon kalimin nga raportet dhe indekset e mëparshme të hartuara për Kosovën.

Një kontribut i veçantë i këtij raporti është vlerësimi i indekseve duke përdorur pesha të barabarta për secilin nën-indeks, por gjithashtu duke përdorur edhe pesa specifike në bazë të rëndësisë së politikave publike. Versioni i fundit trajton përbrendëson rëndësinë e secilit nën-indeks në shpjegimin e qeverisjes lokale (dmth. transparenca e qeverisjes është më e rëndësishme se numri i ditëve për të regjistruar biznesin në konkurrueshmërinë e përgjithshme të qeverisjes në mjedisin konkurrues afarist). Për të përcaktuar peshat e indeksit, është përdorur një qasje statistikore me tri hapa duke përfshirë Analizën e Faktorëve. Teknika shpjegohet në seksionin e metodologjisë.

FIGURA 7.1. Korniza e metodologjisë së IKK-së



## 7.1. Grumbullimi

Mbledhja e të dhënave është faza e parë e zbatimit të hulumtimit dhe përfshin zgjedhjen e treguesve të qeverisjes që janë të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit privat në nivel komunal. Treguesit vendosen në bazë të kuadrit adekuat teorik teorike dhe në bazë të specifikave të vendit, si dhe sugjerimet e ekspertëve ekonomikë. Të dhënat e përdorura janë grumbulluar përmes anketës së kryer në 38 komuna të Kosovës. Instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave ka qenë anketa me biznese në Kosovë.

### Dizajni i anketës

IKK është një tregues agregat i përbërë nga 8 nën-indekse bazë për matjen e konkurrueshmërisë. Për të hartuar 8 nën-indekset, janë shtruar 48 pyetje. Ky është viti i pestë i zbatimit të IKK-së në Kosovë nga USAID-i, dhe pyetësori i përdorur ka mbajtur koherencën me pyetjet e përdorura për të nxjerrë indekset që mund të krahasohen me të kaluarën.

6 pyetjet e para ishin pyetje të përgjithshme rreth mendimit të bizneseve për ekonominë lokale dhe performancën e përgjithshme të bizneseve. Këto pyetje janë përdorur për të përshkruar karakteristikat e firmave të intervistuara dhe perceptimin e mjedisit lokal afarist.

Pjesa tjetër e pyetjeve është organizuan në grupe prej 5 deri në 7 pyetje, ku secili grup specifikon një nën-indeks, duke përfshirë: (1) barrierat e hyrjes në biznes, (2) transparencën, (3) pjesëmarrjen dhe parashikueshmërinë, (4) kostot kohore (5) taksat dhe tarifat, (6) administratën komunale, (7) fuqinë punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese, dhe (8) infrastrukturën. Pyetjet janë formuluar duke përdorur gjuhë dhe koncepte të kuptueshme dhe të njëjtat janë testua gjatë fazës së testimit.

### Mostra

Popullacioni nga i cili është nxjerrë mostra e shtresuar në mënyrë rastësore e 3350 firmave për 38 komunat e Kosovës është lista e bizneseve aktive nga ARBK, me n=100 firma për secilën komunë. Mostrimi rastësor ka filluar duke analizuar bazën e të dhënave të bizneseve aktive të Kosovës nga ARBK-ja dhe janë filtruar vetëm bizneset aktive, pasi ka një prani të konsiderueshme të firmave 'fantazmë'. Për të bërë një gjë të tillë, ekipi hulumtues ka krahasuar bazën e të dhënave të ARBK-së me informacionin e marrë nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Rrjedhimisht, meqenëse qëllimi i hulumtimit ishte krahasimi i qeverisjes ndërmjet komunave, 38 mostra të ndara të firmave në nivel komunal janë nxjerrë në mënyrë rastësore duke kontrolluar për dallimet në industri, komuna dhe llojin e statusit ligjor të firmave, duke u bazuar në praktikën e dizajnimit të IKK-së të Kosovës.

Në përgjithësi, mostra e synuar prej 100 intervistave për komunë është arritur në shumicën e komunave. Komunat me një mostër më të vogël janë zakonisht komuna të vogla, ku popullsia e bizneseve është më e vogël se 100. Në këto raste, është intervistuar i gjithë popullacioni (Hani i Elezit dhe Juniku). Komunat më të mëdha si Prishtina, Mitrovica dhe Prizreni, në anën tjetër, kanë mostra pak më të mëdha të anketimit; deri në 190 anketa.

## TABELA 7.1.1 IKK 2018 Shpërndarja e mostrës

| Komuna | # i anketave të kompletuara | Komuna | # i anketave të kompletuara |
|---|---|---|---|
| Deçan | 101 | Mitrovicë | 101 |
| Dragash | 101 | Mitrovica e Veriut | 89 |
| Gllogoc | 98 | Novobërdë | 76 |
| Ferizaj | 100 | Obiliq | 100 |
| Fushe Kosove | 92 | Partesh | 51 |
| Gjakovë | 100 | Pejë | 97 |
| Gjilan | 100 | Podujevë | 100 |
| Graçanicë | 100 | Prishtinë | 129 |
| Hani i Elezit | 51 | Prizren | 121 |
| Istog | 100 | Rahovec | 102 |
| Junik | 47 | Ranillug | 43 |
| Kaçanik | 99 | Shtërpcë | 77 |
| Kamenice | 100 | Shtime | 100 |
| Klinë | 101 | Skenderaj | 92 |
| Kllokot | 49 | Suharekë | 100 |
| Leposaviq | 31 | Viti | 100 |
| Lipjan | 101 | Vushtrri | 101 |
| Malishevë | 125 | Zubin Potok | 41 |
| Mamushë | 78 | Zveçan | 48 |

### Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave primare është bërë përmes intervistave ballë për ballë me përfaqësuesit e bizneseve anembanë Kosovës. Intervistat u organizuan përmes thirrjeve telefonike me pronarët, ose drejtuesit e nivelit të lartë të firmave.

70 anketues janë angazhuan në kryerjen e anketave anembanë Kosovës me një mesatare prej 50 intervistash të kryera nga një anketues i vetëm. Numri i madh i anketuesve të përfshirë ka ndihmuar në zvogëlimin e paragjykimit të anketuesve sa i përket trajtimit individual të procesit të intervistimit.

Pas hartimit të protokollit të hulumtimit, ekipi i anketuesve është trajnuar, fillimisht duke iu prezantuar qëllimi i studimit, vijuar nga procesi i grumbullimit të të dhënave dhe më në fund është bërë rishikimi grupor i secilës pyetje.

15 për qind e anketave janë ri-verifikuar nga ekipi për të siguruar që përgjigjet në disa pyetje të përzgjedhura korrespondojnë me përgjigjet e plotësuara nga anketuesit. Këto pyetje përfshinin ato që konsideroheshin më thelbësore për qëllimet e hulumtimit, si pyetjet që gjatë kontrollit logjik sinjalizonin mospërputhje të mundshme. Ky aktivitet ishte pjesë e një kontrolli në terren dhe është kryer përmes intervistave telefonike dhe vizitave në terren.

Gjithashtu është kryer një kontroll logjik pasi që pyetësorët janë plotësuar. Çdo pyetësor është verifikua nga hulumtuesit për të kontrolluar nëse ka ndonjë përgjigje të paarsyeshme ose përgjigje që nuk përputhen me përgjigjet në pyetjet tjera në pyetësor. Ky proces ka ndihmuar që të evidentohen defektet eventuale brenda çdo ankete. Në rastet kur ka pasur mospërputhje logjike, ekipi i hulumtuesve bashkëpunim me anketuesit kanë vizituar sërish biznesin apo e kanë telefonuar. Kontrolli logjik ka ndihmuar në identifikimin e anketave që mund të jenë plotësuar në mënyrë jo korrekte nga anketuesit. Numri i anketave të tilla të cilat kanë dështuar për të kaluar kontrollin logjik ka qenë 20.

## 7.2. Ndërtimi

Secili nga 8 nën-indekset e IKK-së ka një rezultat maksimal prej dhjetë pikëve. Ndërtimi i indeksit të IKK-së së pari është dizajnuar që të paraqes një mesatare të thjeshtë të vlerave të nën-indekseve. IKK gjithashtu është konstruktuar duke përdorur ponderimin duke përdorur peshën specifike të politikave publike. Këto pesha janë vlerësuar përmes një analize shtesë ekonometrike

Para kryerjes së analizës, ekipi i autorëve ka testuar bazën e të dhënave për vlera që janë abnormalisht të larta ose të ulëta, duke përdorur dallimin ndërmjet kuartaleve. Një gjë e tillë është bërë për të shmangur rrezikun e shtrembërimit të analizave statistikore siç janë mesataret dhe devijimet standarde. Fillimisht janë kalkuluar kuartali i parë dhe kuartali i tretë dhe më pas është gjetur dallimi mes tyre. Të dhënat që kanë rënë përtej kufirit të sipërm dhe të poshtëm janë testuar duke përdorur metoda adekuate për eliminimin e vlerave që janë abnormalisht të larta dhe të ulëta dhe të njëjtat janë larguar.

### IKK i papeshuar

Nën-indekset janë standardizuar duke përdorur një shkallë prej dhjetë pikëve, gjë që eliminon dallimet në matje gjatë vlerësimit të rezultateve përfundimtare të IKK-së. Për të standardizuar indekset, është përdorur formula e mëposhtme:

$$9 * [\frac{Komuna_1 - Minimumi}{Maksimumi - Minimumi}] + 1$$

, ku *Komuna1* paraqet vlerën e komunës individuale, *Minimumi* paraqet vlerën më të vogël të ndonjë komunë, dhe *Maksimumi* paraqet vlerën më të lartë të ndonjë komune.

Për disa komponentë të nën-indekseve, vlerat e mëdha kanë interpretim negativ. Në këto raste, formula është përmbysur duke zbritur të gjithë vlerën nga formula e mëparshme nga numri njëmbëdhjetë. Një shembull i një komponenti negativ do të ishte numri i ditëve që nevojiten për të regjistruar një biznes në bazë të raportimit të bizneseve:

$$11 - [9 * [\frac{Komuna_1 - Minimumi}{Maksimumi - Minimumi}] + 1]$$

Së fundi, rezultatet e nën-indekseve janë llogaritur si një mesatare e thjeshtë e komponentëve të treguesit të standardizuar.

# 7.3. Kalibrimi

**IKK i ponderuar**

Një kontribut i rëndësishëm i këtij raporti të IKK-së është vlerësimi i peshave të politikës publike në ponderimin e nën-indekseve, gjë që sinjalizon fushat me rëndësi më të madhe për reformimin e politikave publike. Për të vlerësuar kontributin e secilit prej nën-indekseve në performancën e sektorit privat, autorët kanë njekur një teknikë që përfshin tre hapa të analizës statistikore.

Së pari, është përdorur analiza e faktorëve për të ndarë nën-indekset në dy faktorë të pa lidhur (shporta të ndryshoreve). Përveç kësaj, ky hap krijoi "ngarkesat e faktorëve", të cilët janë korrelacion bivariat midis çdo nën-indeksi dhe këtyre faktorëve të pa lidhur. Së dyti, duke përdorur metodën e regresionit është parashikuar vlera e një ndryshoreje të varur që matë performancën e sektorit privat (matës i përafërt i rritjes së firmës) në bazë të dy faktorëve të vlerësuar në 'Hapin 1'. Regresioni është testuar duke kontrolluar për madhësinë e firmës dhe statusin ligjor dhe në çdo specifikacion, koeficientet e faktorëve mbeten statistikisht domethënës ndërsa madhësia e koeficientëve nuk ndryshon ndjeshëm. Së treti, koeficientet e regresionit janë shumëzuar me ngarkesën e faktorit të secilit nën-indeks të paraqitur në hapin e parë në mënyrë që të izolojë efektin e secilit nën-indeks në ndryshoren e varur. Në fund, peshat janë rrumbullaksuara për të krijuar një total prej 100 pikësh për indeksin.

Tabela më poshtë përmbledh shkurtimisht hapat kryesorë të gjenerimit të peshave. Tabelat e detajuara të gjenerimit të indekseve janë paraqitur në shtojcë të raportit.

Testimi i strategjisë për të vlerësuar peshat e nën-indekseve është i domosdoshëm për shkak të korrelacionit të lartë ndërmjet nën-indekseve dhe rrezikut të devijimit të rezultateve për shkak të multikolinearitetit. Për të testuar vlefshmërinë e analizës së faktorëve për të dhënat tona, është përdorur testi Kaiser-Meyer-Olkin (KMO) i cili matë kovariancën ndërmjet ndryshoreve. Si rregull, një KMO më i madh se 0.5 tregon se të dhënat janë të përshtatshme për analizë të faktorëve dhe kështu KMO-ja jonë prej 0.58 konfirmon se të dhënat janë të përshtatshme për analizën e faktorëve, duke validuar kështu strategjinë tonë kërkimore.

TABELA 7.3.1 Hapat kryesorë të gjenerimit të peshave të IKK-së

HAPI 1 **Gjeni kontributin e faktorëve në ndryshoren e përafërt që matë performancën e sektorit privat**

| VARIABLAT | (1) Specifikimi 1 | (2) Specifikimi 2 | (3) Specifikimi 3 | (4) Specifikimi 4 |
|---|---|---|---|---|
| factor1 | **-0.0641**** | -0.0735** | -0.0656** | **-0.0706**** |
| | (0.0309) | (0.0312) | (0.0315) | (0.0318) |
| factor2 | **-0.143***** | -0.141*** | -0.131*** | **-0.131***** |
| | (0.0346) | (0.0346) | (0.0380) | (0.0380) |
| legal_status | | 0.108*** | | 0.0681* |
| | | (0.0335) | | (0.0348) |
| empl | | | 0.0295*** | 0.0279*** |
| | | | (0.00606) | (0.00614) |
| Constant | 1.000*** | 0.867*** | 0.887*** | 0.809*** |
| | (0.0263) | (0.0484) | (0.0343) | (0.0523) |
| Observations | 3,343 | 3,343 | 3,217 | 3,217 |

Gabimi standard në kllapa

*** p<0.01, ** p< 0.05, * p<0.1

HAPI 2 **Shumëzoni rezultatet e faktorëve të derivuar (në hapin 1, specifikimi 1) me ngarkesat e nën-indekseve në faktorë dhe më pas ndani rezultatin me kontributin total për të nxjerrë peshat**

| | Faktori 1 | Faktori 2 | Peshat | Peshat e rrumbullaksuara |
|---|---|---|---|---|
| sub_1 | 0.08 | 0.21 | 10.2% | 10 |
| sub_2 | 0.20 | 0.18 | 13.3% | 15 |
| sub_3 | 0.19 | 0.29 | 16.9% | 15 |
| sub_4 | 0.05 | 0.38 | 15.2% | 15 |
| sub_5 | 0.15 | 0.28 | 15.2% | 15 |
| sub_6 | 0.17 | 0.15 | 11.4% | 10 |
| sub_7 | 0.08 | 0.21 | 9.9% | 10 |
| sub_8 | 0.22 | 0.01 | 7.9% | 10 |
| | | | 100.0% | 100 |

TABELA 7.3.2 Matja Kaiser-Meyer-Olkin lidhur me përshtatshmërinë e mostrimit

| Ndryshorja | KMO |
| --- | --- |
| sub_1 | 0.5035 |
| sub_2 | 0.6064 |
| sub_3 | 0.6552 |
| sub_4 | 0.3743 |
| sub_5 | 0.6020 |
| sub_6 | 0.6294 |
| sub_7 | 0.4950 |
| sub_8 | 0.6683 |
| **I plotë** | **0.5871** |

## 7.4. Diskutimet në grupet e fokusuara - Metodologjia

Këtë vit, IKK ka shtuar një aspekt të ri, duke mbledhur të dhënat primare në formën e fokus grupeve nga diskutimet me zyrtarët komunalë, OJQ-të e ndryshme lokale dhe bizneset. Kjo shtesë kishte për qëllim të prodhonte të dhëna cilësore, bazuar në rezultatet e mbledhura nga anketimi me biznese i realizuar në të gjitha 38 komunat e Kosovës. Grupet e fokusit u zhvilluan në shtatë rajone të Kosovës me 6-10 pjesëmarrës. Gjatë dy javëve, ekipi hulumtues vizitoi Ferizajn, Prizrenin, Gjakovën, Pejën dhe Mitrovicën dhe organizoi fokus grupet me komunat që bien në kufijtë administrativë të këtyre shtatë rajoneve. Grupet e fokusit për rajonet e Prishtinës dhe Gjilanit u organizuan në Prishtinë.

Udhëzuesi për organizimin e fokus grupeve u zhvillua duke pasur parasysh nevojën për të mbledhur të dhëna shtesë për sa i përket kërkimit cilësor. Procesi i hulumtimit filloi me analizë cilësore, ku u zhvilluan shtatë diskutime në fokus grupe. Pjesëmarrësit në të gjitha diskutimet e grupeve të fokusit ishin përfaqësues nga administrata lokale komunale kryesisht drejtues të Drejtorive të Zhvillimit Ekonomik. Kohëzgjatja mesatare e diskutimit të grupeve të fokusit ishte rreth 120 minuta. Grupet e fokusit u moderuan dhe u transkriptuan nga hulumtuesi kryesor i ekipit dhe më pas u analizuan për raportin përfundimtar nëpërmjet një procedure kodimi nga një studiues tjetër për të shmangur çdo boshllëk metodologjik.

Hetimi i pyetjeve të bëra gjatë diskutimeve të grupeve të fokusit buronte nga temat e mbuluara në indekset e anketës me 3350 biznese në 38 komunat e Kosovës. Pyetjet e bazuara në nën-indekset synonin të shmangnin devijimet nga diskutimi. Pyetjet hyrëse kishin për qëllim të informonin pjesëmarrësit për natyrën e këtij projekti. Pjesëmarrësit u njoftuan me rezultatet paraprake nga anketa për të pasur një pasqyrë më të saktë të asaj që pritet nga ky hulumtim. Pyetjet janë ndërtuar në mënyrë të tillë që pjesëmarrësit tanë të kenë mundësinë të shprehin mendimet nga perspektiva e tyre profesionale. Grupi më i madh i pjesëmarrësve ishin zyrtarë komunalë nga Drejtoritë për Zhvillim Ekonomik. Marrëdhëniet e biznesit dhe zhvillimi i sektorit privat në shumicën e komunave të Kosovës është brenda përgjegjësive të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Grupi i dytë i pjesëmarrësve përbëhej nga përfaqësues të OJQ-ve ose fondacioneve që veprojnë në nivel rajonal ose mbarëkombëtar. Ekspertiza dhe eksperienca e tyre ka qenë e domosdoshme dhe ka shërbyer si një katalizator në mes të sektorit publik dhe atij privat. Grupi i fundit përbëhej nga bizneset e industrive të ndryshme që funksiononin në ato rajone ku u mbajtën fokus grupet. Meqenëse fokusi kryesor nga i cili është shkruar ky raport vjen nga opinionet dhe përvojat e bizneseve, shkalla e pjesëmarrjes së bizneseve në fokus grupe ishte më e vogël në krahasim me grupet e tjera.

TABELA 7.4.1 Përfaqësimi në grupet e fokusit; struktura e pjesëmarrësve në të gjithë shtatë grupet e fokusuara.

| | Përfaqësues komunalë | OJQ lokale | Përfaqësues të bizneseve |
| --- | --- | --- | --- |
| DISKUTIMI NË FOKUS GRUPE | 26 | 12 | 7 |

## TABELA 7.4.2 Pyetjet kryesore për diskutimet në grupet e fokusuara

<table>
<tr><th>Lloji i pyetjes</th><th>Pyetjet kryesore në diskutimet në grupe të fokusuara</th></tr>
<tr><td>Pyetje fillestare</td><td>Pas prezantimit të pjesëmarrësve, është bërë pyetja fillestare në lidhje me raportin e IKK-së:<br>Cilat janë për ju përparësitë dhe mangësitë kryesore për të bërë biznes në komunën tuaj?</td></tr>
<tr><td>Pyetje hyrëse</td><td>Çka mendoni ju, cili është roli i qeverisjes lokale (komunës) në përmirësimin e mjedisit afarist?</td></tr>
<tr><td>Pyetje kalimtare</td><td>Sipas mendimit tuaj, deri në çfarë mase ka bashkëpunim ndërmjet komunës suaj dhe bizneseve?</td></tr>
<tr><td>Pyetjet kryesore</td><td>PYETJE PËR ZYRTARËT KOMUNALË:<br><br>Cilat janë pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset në komunën tuaj?<br>- A ka identifikuar komuna juaj këto barriera?<br>- Cilat janë mjetet e informimit për tenderët e rinj, grantet, debatet publike apo ndryshimet në rregulloret?<br>- Cilat ishin masat që komuna juaj ka ndërmarrë për të ulur taksat?<br>- A ka komuna ndonjë strategji afatgjate për rigjallërimin e shkollave profesionale në komunat tuaja?<br>- A ka bërë ndonjëherë komuna një vlerësim të zyrtarëve komunalë?<br>- A ka komuna juaj një zyrë ligjore këshilluese dhe një zyrë për promovimin e biznesit?<br><br>PYETJE PËR BIZNESET:<br><br>A keni hasur probleme në komunë lidhur me procedurat për regjistrimin ose marrjen e lejeve dhe licencave?<br>- Sa ditë janë të nevojshme dhe sa dokumente janë kërkuar për marrjen e licencave?<br>- A jeni në dijeni të njoftimeve dhe debateve publike? A merrni pjesë në to?<br>- A ka ndonjë taksë apo pagesë që e ngarkon punën e biznesit tuaj?<br>- A gjeni gjithmonë fuqi punëtore të kualifikuar?<br>- Si janë përvojat tuaja me zyrtarët komunalë?</td></tr>
<tr><td>Pyetjet përfundimtare</td><td>Së fundi, a ka ndonjë gjë që lidhet me diskutimin sot, që nuk është diskutuar dhe duket se është e rëndësishme për ju, apo keni ndonjë vlerësim tjetër që dëshironi ta ndani me ne?</td></tr>
</table>

# 8 PËRFUNDIMET

IKK është një tregues agregat i përbërë nga 8 nën-indekse bazë për matjen e konkurrueshmërisë. Nën-indekset e standardizuara matin dimensionet kyçe të ndikimit të qeverisjes lokale në mjedisin afarist: (1) barrierat e hyrjes në biznes, (2) transparencën, (3) pjesëmarrjen dhe parashikueshmërinë, (4) kostot kohore (5) taksat dhe tarifat, (6) administratën komunale, (7) fuqinë punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese, dhe (8) infrastrukturën.

Ky është viti i pestë i zbatimit të IKK-së në Kosovë nga USAID-i, dhe pyetësori i përdorur ka mbajtur koherencë me pyetjet e përdorura për të nxjerrë indekset në të kaluarën. Metodologjia e përdorur bazohet në metodologjinë e Fondacionit Aziatik për indekset ekonomike të qeverisjes lokale. Për të ndërtuar indekset, procesi i hulumtimit ka kaluar nëpër tri faza, atë të: grumbullimit, ndërtimit dhe kalibrimit.

Faza e grumbullimit përfshinte përzgjedhjen e nën-indekseve të qeverisjes që kanë të bëjnë me sektorin privat në nivel komunal. Të dhënat e mbledhura kryesisht përmes anketës. 3350 biznese janë anketuar në të gjitha 38 komunat e Kosovës duke përdorur një mostër të shtresuar në mënyrë rastësore. Ndërtimi i indeksit të IKK-së fillimisht është bërë duke paraqitur atë si mesatare e thjeshtë e nën-indekseve. Ndërsa në fazën e kalibrimit, IKK është paraqitur si mesatare e ponderuar duke përdorur pesha specifike të politikave publike dhe ndikimit që kanë në nën-indekset individualë. Përcaktimi i peshave është bërë përmes një analize shtesë ekonometrike.

Dallimet në vlerat e indeksit komunal nuk është i madh, pasi indeksi paraqet një mesatare të thjeshtë të vlerave të nën-indekseve dhe kështu nuk përfill ndryshimin brenda indekseve (gjë që është paraqitur në seksionet vijuese). Dhjetë komunat me performancë më të mirë janë: Lipjani, Rahoveci, Vitia, Juniku, Hani i Elezit, Gjakova, Podujeva, Obiliqi, Prishtina dhe Suhareka.

IKK gjithashtu është konstruktuar duke përdorur peshimin. Përdorimi i peshave të politikave publike ndryshon paksa renditjen e komunave me rezultat më të mirë. Me përjashtim të Lipjanit, pozitat e komunave tjera ndryshohen. Suhareka gjithashtu nuk është më në listën e 10 komunave që prijnë me rangim, përderisa kësaj liste i shtohet Parteshi.

Së fundmi, rezultatet e nxjerra nga diskutimet e fokus grupeve kanë plotësuar studimin me gjetjet cilësore në lidhje me konkurrueshmërinë e komunave në lidhje me bizneset. Gjetja kryesore e grupeve të fokusuara është nevoja më e madhe e bizneseve dhe komunave për të thelluar bashkëpunimin. Për më tepër, ekzistojnë disa ngjashmëri mes komunave bazuar në madhësinë e tyre. Komunat e vogla përballen kryesisht me probleme financiare për shkak të buxheteve të vogla, edhe pse kufizimet buxhetore janë një problem që prekin të gjitha komunat, kjo është veçanërisht e theksuar për komunat e vogla dhe të mesme. Rrjedhimisht, ato nuk arrijnë të përmirësojnë infrastrukturën lokale për shkak të mungesës së investimeve. Zyrtarët nga komunat e vogla gjithashtu kanë probleme në ofrimin e këshillave për bizneset për shkak të burimeve njerëzore joadekuate, ndërsa problemet kryesore të shprehura nga bizneset në komunat e mëdha dhe të mesme janë transparenca e ulët, mungesa e fuqisë punëtore kompetente dhe të kualifikuar.

# 9 SHTOJCAT

. * Factor analysis
. factor $xlist, mineigen (0.9)
(obs=38)

Number of obs = 38
Retained factors = 2
Number of params = 15

Factor analysis/correlation
Method: principal factors
Rotation: (unrotated)

| Factor | Eigenvalue | Difference | Proportion | Comulative |
|---|---|---|---|---|
| Factor1 | 2.01986 | 1.06053 | 0.6724 | 0.6724 |
| Factor2 | 0.95933 | 0.45964 | 0.3193 | 0.9917 |
| Factor3 | 0.49968 | 0.29457 | 0.1663 | 1.1581 |
| Factor4 | 0.20512 | 0.16390 | 0.0683 | 1.2263 |
| Factor5 | 0.04122 | 0.18024 | 0.0137 | 1.2401 |
| Factor6 | -0.13902 | 0.13148 | -0.0463 | 1.1938 |
| Factor7 | -0.27050 | 0.04112 | -0.0900 | 1.1037 |
| Factor8 | -0.31162 | | -0.1037 | 1.0000 |

LR test: independent vs. saturated: chi2 (28) = 70.69 Prob>chi2 = 0.0000

## SCREE PLOT OF EIGENVALUES AFTER FACTOR




**Factor loading (pattern matrix) and unique variances**

| Variable | Factor 1 | Factor 2 | Uniqueness |
|---|---|---|---|
| sub_1 | 0.2500 | 0.3108 | 0.8409 |
| sub_2 | 0.6454 | -0.2624 | 0.5146 |
| sub_3 | 0.6188 | -0.4238 | 0.4375 |
| sub_4 | 0.1683 | 0.5546 | 0.6641 |
| sub_5 | 0.4930 | 0.4101 | 0.5885 |
| sub_6 | 0.5633 | 0.2222 | 0.6333 |
| sub_7 | 0.2537 | -0.2980 | 0.8468 |
| sub_8 | 0.7106 | 0.0121 | 0.4949 |

| NDRYSHORET | (1)<br>Specifikimi 1 | (2)<br>Specifikimi 2 | (3)<br>Specifikimi 3 | (4)<br>Specifikimi 4 |
|---|---|---|---|---|
| factor1 | -0.0641** | -0.0735** | -0.0656** | -0.0706** |
| | (0.0309) | (0.0312) | (0.0315) | (0.0318) |
| factor2 | -0.143*** | -0.141*** | -0.131*** | -0.131*** |
| | (0.0346) | (0.0346) | (0.0380) | (0.0380) |
| legal_status | | 0.108*** | | 0.0681* |
| | | (0.0335) | | (0.0348) |
| empl | | | 0.0295*** | 0.0279*** |
| | | | (0.00606) | (0.00614) |
| Constant | 1.000*** | 0.867*** | 0.887*** | 0.809*** |
| | (0.0263) | (0.0484) | (0.0343) | (0.0523) |
| Observations | 3,343 | 3,343 | 3,217 | 3,217 |

Gabimi standard në kllapa

*** p<0.01, ** p< 0.05, * p<0.1

**. * Scores of the components**

**. predict f1 f2**

**(regression scoring assumed**

**Scoring coefficients (method = regression)**

| Variable | Factor 1 | Factor 2 |
|---|---|---|
| sub_1 | 0.06865 | 0.16112 |
| sub_2 | 0.25585 | -0.17898 |
| sub_3 | 0.24873 | -0.31166 |
| sub_4 | 0.06462 | 0.34496 |
| sub_5 | 0.19663 | 0.26187 |
| sub_6 | 0.18742 | 0.15137 |
| sub_7 | 0.06742 | -0.14871 |
| sub_8 | 0.30268 | 0.03365 |